



Instituti për të drejtat e njeriut



Auswärtiges Amt



Human Rights



# ANALIZË

e vendimeve dhe aktvendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut lidhur me kërkesat e paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave

**Titulli** (përkthyer nga maqedonishtja në shqip):

Analizë e vendimeve dhe aktvendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut lidhur me kërkesat e paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave

**Titulli original:**

Анализа на одлуките и решенијата на Уставниот суд на Република Северна Македонија по поднесени барања за заштита на слободите и правата

**Editor:**

Instituti për të Drejtat e Njeriut

**Për editorin:**

Margarita Caca Nikollovska

**Redaktore:**

dr. Vesna Stefanovska

**Autorë:**

Igor Spirovski

Margarita Caca Nikollovska

**Përktheu:**

Blerina Starova Zllatku

**Dizajni grafik:**

Bisera Atanasovska

**Shkup, 2023**

*Kjo analizë është bërë me mbështetjen financiare të Ambasadës Gjermane. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e Institutit për të Drejtat e Njeriut dhe nuk pasqyron pikëpamjet e ambasadës ose qeverisë gjermane.*

CIP - Каталогизација во публикација Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.565.2:342.72/.73.037(497.7)"1992/2023"(094.8)(047.31)

SPIROVSKI, Igor

Analizë e vendimeve dhe aktvendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut lidhur me kërkesat e paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave [Електронски извор] / Igor Spirovski, Margarita Caca Nikollovska ; përktheu Blerina Starova Zllatku. - Текст во ПДФ формат, содрж. 30 стр. - Shkup : Instituti për të Drejtat e Njeriut, 2023

Начин на пристапување (URL): <https://ihr.org.mk/al/publikime>. - Наслов преземен од екран.

- Опис на изворот на ден 13.12.2023 год.

**ISBN 978-608-5032-05-1**

1. Caca Nikollovska, Margarita [автор]

а) Уставен суд -- Човекови права и слободи -- Заштита -- Македонија -- 1992-2023 -- Одлуки и решенија -- Истражувања

**COBISS.MK-ID 62607109**

# Содржина

<b>HYRJE</b>	<b>5</b>
<b>QASJA METODOLOGJIKE</b>	<b>6</b>
<b>1. BAZAT NORMATIVE</b>	<b>7</b>
Kompetenca	7
Procedura	7
Llojet dhe veprimi juridik i vendimeve	7
<b>2. ANALIZA E PRAKTIKËS</b>	<b>8</b>
Numri dhe struktura e lëndëve	8
Analiza e vendimeve dhe aktvendimeve që kanë të bëjnë me procedurën	9
Analiza e aspektit meritot të vendimeve	12
Vendime me të cilat është përcaktuar shkelje	12
Vendime me të cilat është refuzuar kërkesa	15
Aktvendime për hedhjen poshtë të kërkesës	20
<b>3. MONITORIMI I SEANCAVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE NË PERIUdhËN KOHORE PRILL - TETOR 2023</b>	<b>23</b>
Veprimet e Gjykatës Kushtetuese ndaj kërkesave të paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave – gjetjet nga monitorimi	23
<b>KONKLUSIONE</b>	<b>26</b>
<b>REKOMANDIME</b>	<b>27</b>



Kjo analizë, nëpërmjet shqyrtimit të të gjitha vendimeve dhe aktvendimeve të miratuara nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV) në periudhën kohore nga viti 1992 deri në vitin 2023, synon ta perceptojë ushtrimin e kompetencës, përkatësisht juridiksionit nga pikëpamja e bazave dhe supozimeve normative, botëkuptimeve juridike dhe doktrinave të aplikuara në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.<sup>1</sup> Nga ana tjetër, duhet t'i identifikojë çështjet që mund të jenë baza për avancimin e nivelit të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave, veçanërisht nga këndvështrimi i dokumenteve ndërkombëtare, siç janë Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe të tjera, si dhe nga pikëpamja e ndikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese.

Gjyqësori Kushtetues, tani më i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka ekzistuar në vazhdimësi për gati gjashtë dekada. Gjykata Kushtetuese, sipas pozitës së vet, nuk është pjesë e sistemit të organizimit të pushtetit shtetëror, por është një autoritet i veçantë kushtetues me status sui generis, me përbërje, organizim dhe kompetenca konkrete, të përcaktuara në vetë Kushtetutën. Pozita e tillë e pavarur e Gjykatës Kushtetuese konsiderohet si premisë për ushtrimin e papengueshëm të funksionit kushtetues gjyqësor, të mbrojtur nga ndikimet politike dhe të ndarë nga gjyqësori i rregullt.

Pozita, përbërja, kompetenca dhe veprimi juridik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese janë përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa mënyrën e punës dhe procedurën para Gjykatës Kushtetuese e përcakton Gjykata, me aktin e saj, përkatësisht me Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së. Kompetencën për të miratuar një akt të tillë Gjykata e merr nga neni 113 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në këtë konotacion, nuk duhet të minimizohet rëndësia e natyrës juridike, karakteri dhe vlefshmëria normative e Rregullores, ndërkaq është e rëndësishme të theksohet autorizimi kushtetues i Gjykatës Kushtetuese të miratojë një akt për rregullimin e mënyrës së punës dhe procedurën para Gjykatës Kushtetuese. Duke u nisur nga kjo, vlerësimi i asaj se çka mundet dhe çka nuk mund të rregullohet me “aktin” e Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 113 të Kushtetutës, bazuar në perceptimin e këtij akti si “rregullore” në kuptimin administrativ-juridik, mbështetet në një supozim dukshëm të gabuar, jo thelbësor, dhe së këtejmi një supozim formalist që e injoron nenin 113 të Kushtetutës. Në këtë kuptim, është e papranueshme të thuhet se çështja, e cila në thelb i referohet dispozitave të procedurës para Gjykatës Kushtetuese, siç është veprimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese që e miraton gjatë ushtrimit të kompetencës së saj, të përcaktuar me Kushtetutë, të mos mund të rregullohet me Rregullore.<sup>2</sup>

Përmes analizës së vendimeve dhe aktvendimeve të Gjykatës Kushtetuese lidhur me kërkesat e paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, Analiza ofron një pasqyrë sa i përket veprimit/procedimit të Gjykatës Kushtetuese, zbatimit të Kushtetutës dhe Rregullores në punën e saj, zbatimit të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) dhe praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Rrjedhimisht, qëllimi i Analizës është të jetë bazë për zhvillimin e një diskutimi në mesin e publikut profesional, lidhur me nevojën e zgjerimit të spektrit për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave dhe për inkorporimin e mekanizmit të ankesës/rekursit ose padisë kushtetuese, gjë e cila, sikur ekziston në një fushë të caktuar. Është e rëndësishme të analizohet dhe të merret parasysh numri i vogël i kërkesave të paraqitura. Mbetet e hapur çështja nëse zgjerimi eventual i spektrit dhe inkorporimi i mekanizmit të ri, do të kishte efekt pozitiv në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave?

1 Vendimet dhe aktvendimet e Gjykatës Kushtetuese, lidhur me kërkesat e paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, janë të aksesshme në faqen e internetit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut <https://ustavensud.mk/>

2 Caca Nikolovska, Margarita; Spirovski, Igor; Sopronov, Martin. Analizë e thellë – Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut: përvojat dhe perspektivat. Instituti për të Drejtat e Njeriut, viti 2021.

# QASJA METODOLOGJIKE

Qëllimi thelbësor metodologjik i kësaj Analize është hartimi i një teksti të qartë dhe preciz, i cili pa mëdyshje do të japë një vështrim mbi praktikën e deritanishme gjatë vendimmarrjes ndaj lëndëve që kanë të bëjnë me kërkesat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave.

Çështja kryesore të cilës analiza përpiket t'i përgjigjet, konsiston me atë se cilat janë bazat dhe botëkuptimet juridike gjatë vendimmarrjes ndaj kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe a ekziston mundësi për avancimin e të menduarit dhe vendimmarrjes në drejtim të mbrojtjes së plotë të të drejtave të njeriut? Qëllimi i Analizës është të vlerësohet se sa efikas është mekanizmi për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarëve, në funksion të mbrojtjes dhe sundimit të ligjit. Me Analizën, bëhen përpjekje të përcaktohet se çfarë është praktika gjyqësore në lidhje me shkeljen e përcaktuar/kontestuar, kërkesat dhe aktvendimet e refuzuara për hedhjen poshtë të kërkesave, në lidhje me të menduarit juridik dhe punën e përditshme të Gjykatës. Për më tepër, përmes analizës së punës së Gjykatës Kushtetuese, intenca është të jepet një pasqyrë e qartë sa i përket efikasitetit dhe efektivitetit të saj në vendimmarrjen ndaj kërkesave për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit.

Qasja kërkimore përbëhet nga gërshetimi i grumbullimit të të dhënave dhe analizës së tyre. Grumbullimi i të dhënave është bërë nëpërmjet hulumtimeve prej zyre (desk research) të kuadrit legjislativ ekzistues, të praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese si dhe të raporteve të monitorimit të punës së Gjykatës Kushtetuese, shfrytëzimit të analizës kualitative të përmbajtjeve, metodës krahasuese dhe deduksionit, të gjitha këto si metoda për përpunimin e të dhënave të grumbulluara.

Metodologjia përfshin dy komponentë, përkatësisht: pjesën analitike dhe atë sintetike. Pjesa analitike e analizës ofron disa elemente për shqyrtimin e punës së Gjykatës Kushtetuese dhe mund të ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë, analiza përqendrohet në punën e Gjykatës, në trajtimin e lëndëve dhe vendimmarrjen në seancat dëgjimore publike, ndërsa në pjesën e dytë, theks i veçantë i përkushtohet shkeljes së përcaktuar, kërkesave të refuzuara dhe aktvendimeve për hedhjen poshtë të kërkesave.

Pikënisja është rregullimi legjislativ i Gjykatës Kushtetuese ndërsa pikë referimi është Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në të cilën në Kreun IV specifikohet pozita dhe kompetenca e Gjykatës Kushtetuese dhe cilat liri dhe të drejta ajo mbron. Pastaj, Analiza ofron një pasqyrë të Rregullores me të cilën përcaktohet veprimi/procedimi i Gjykatës Kushtetuese, lidhur me kërkesat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, si dhe llojet dhe veprimi juridik i vendimeve.

Sa i përket pjesës së parë, merren parasysh gjetjet e Raporteve mbi punën e Gjykatës Kushtetuese, duke monitoruar seancat e saj, të udhëhequr nga parimet e profesionalizmit, objektivitetit, paanshmërisë dhe neutralitetit. Qëllimi i monitorimit të seancave të Gjykatës konsiston me grumbullimin e të dhënave statistikore dhe cilësore për punën e saj, përfshirë kërkesat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit. Të dhënat që rezultojnë nga monitorimi i punës së Gjykatës përpunohen në bazë të një Metodologjie të paracaktuar, ndërkaq para publikut prezantohen përmes Raportit mbi Punën e Gjykatës Kushtetuese. Nëpërmjet të dhënave të fituara, analizohen situata të caktuara, si për shembull mënyra e përpilimit të referateve, transparenca gjatë vendimmarrjes, bashkëpunimi me institucionet kompetente, ndërsa do të hapen dilema të caktuara në drejtim të promovimit të këtij mekanizmi, si për shembull, a mundet vetë Gjykata Kushtetuese të iniciojë procedurë, nëse konstaton se ka bazë për një gjë të këtillë.?!

Lidhur me pjesën e dytë, Analiza fokusohet mbi vendimeve dhe aktvendimet që kanë të bëjnë me procedurën dhe aspektin meritore të vendimeve. Ajo i mbulon vendimet dhe aktvendimet që kanë të bëjnë me procedurën dhe në veçanti me çështjen kundër cilit akt mund të paraqitet kërkesë për mbrojtje, zhvillimin e Seancës dëgjimore publike dhe veprimin juridik të vendimit. Analiza e aspektit meritore të vendimeve, i përfshin vendimet me të cilat është përcaktuar shkelje, vendimet me të cilat është refuzuar kërkesa dhe aktvendimet për hedhjen poshtë të kërkesave.

Rezultati i perceptimit të situatave (sintheza) konsiston me punën e Gjykatës Kushtetuese, lidhur me kërkesat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit nga pikëpamja e bazave dhe pre-

misave normative, botëkuptimeve juridike dhe doktrinave gjatë interpretimit të lirive dhe të drejtave, si dhe identifikimin e çështjeve që mund të jenë bazë për avancimin e nivelit të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave, veçanërisht nga aspekti i ndikimit të aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) gjatë vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, që mbështetet me konkluzione dhe rekomandime të duhura.

## 1. BAZAT NORMATIVE

### Kompetenca

Në përputhje me nenin 110 alinenë 3 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut,<sup>3</sup> Gjykata Kushtetuese "i mbron liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, asociimin dhe veprimin politik, dhe ndalimin e diskriminimit të qytetarëve mbi bazë të gjinisë, racës, përkatësisë fetare, kombëtare, sociale dhe politike."

Në nenin 50 paragrafin 1 të Kushtetutës përcaktohet se "çdo qytetar mund të thirret në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë para gjykatave dhe para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë në një procedurë mbi bazën e parimeve të prioritetit dhe urgjencës."

### Procedura

Në nenin 113 të Kushtetutës përcaktohet se mënyra e punës dhe procedura para Gjykatës Kushtetuese rregullohen me akt të Gjykatës Kushtetuese.

Në përputhje me nenin 51 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese<sup>4</sup>: "Çdo qytetar që konsideron se me një akt ose veprim të veçantë i është shkelur e drejta ose liria e tij, të përcaktuara me nenin 110, alinenë 3 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, mund të kërkojë mbrojtje nga Gjykata Kushtetuese në afat prej 2 muajsh nga dita e dërgesës së aktit të veçantë përfundimtar ose të formës së prerë, përkatësisht nga dita e vënies në dijeni për ndërmarrjen e veprimit me të cilin është kryer shkelja, por jo më vonë se 5 vjet nga dita e ndërmarrjes së tij."

Në përputhje të nenin 55 të Rregullores për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, Gjykata Kushtetuese vendos, sipas rregullit, në bazë të Seancës së zhvilluar dëgjimore publike. Në Seancën dëgjimore publike thirren pjesëmarrësit e procedurës dhe Avokati i Popullit, ndërkaq varësisht nga nevoja, mund të thirren edhe persona, organe ose organizata të tjera. Seanca dëgjimore publike mund të mbahet edhe nëse ndonjë nga pjesëmarrësit në procedurë, ose Avokati i Popullit, nuk marrin pjesë, nëse janë ftuar në mënyrë të rregullt.

### Llojet dhe veprimi juridik i vendimeve

Sipas nenit 56 të Rregullores, me vendimin për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, Gjykata Kushtetuese do të përcaktojë nëse ekziston shkelja e tyre dhe, në varësi të saj, do ta anulojë aktin e veçantë, do ta ndalojë veprimin me të cilin është kryer shkelja ose do ta refuzojë kërkesën.

Neni 82 parashikon se me vendimin me të cilin Gjykata Kushtetuese vendos mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara në nenin 110 alinenë 3 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e përcakton mënyrën e shmangies së pasojave nga zbatimi i aktit apo veprimit të veçantë, me të cilat janë shkelur këto të drejta dhe liri.

Konform nenit 71, alineja 3, në lidhje me nenin 28 të Rregullores, Gjykata Kushtetuese me aktvendim do ta hedhë poshtë kërkesën nëse nuk është kompetente për të vendosur për atë, ose nëse ka pengesa të tjera procesuale për vendimmarrje (për shembull, nëse është paraqitur pas skadimit të dy muajve nga miratimi i aktit të veçantë).

3 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.52/1991.

4 Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 70/1992, 202/2019, 256/2020 dhe 65/2021.

## 2. ANALIZA E PRAKTIKËS

### Numri dhe struktura e lëndëve

<b>Numri i lëndëve të formuara në periudhën kohore nga viti 1992 - deri në qershor 2023</b>	336 lëndë
---	-----------

Struktura sipas mënyrës së vendimmarrjes:

<b>VENDIME</b>	
Numri i lëndëve në të cilat është përcaktuar shkelje, si më poshtë:	5
organizim dhe veprim politik	1
liria e mendimit dhe e shprehjes	3
shkelje e përcaktuar të së drejtës për jetë private dhe familjare (në dispozitiv) për shkak të diskriminimit mbi bazë të përkatësisë sociale	1

<b>VENDIME</b>	
<b>Numri i lëndëve në të cilat është refuzuar kërkesa për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave</b>	50
Liria e mendimit dhe e shprehjes	24
Veprimi politik	3
Diskriminim mbi baza të ndryshme, si më poshtë:	
përkatësia sociale ose statusi social	9
përkatësia kombëtare (etnike)	5
përkatësia kombëtare dhe fetare	2
përkatësia kombëtare dhe politike	1
përkatësia politike	1
seksi	1

Gjykata me vendim i refuzoi kërkesat për shkak të jokompetencës, me arsyetimin për hedhjen poshtë	4
Gjykata miratoi aktvendime për hedhjen poshtë të kërkesave	284



## Analiza e vendimeve dhe aktvendimeve që kanë të bëjnë me procedurën

### ***Kush mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave?***

Sa i përket çështjes se kush mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, neni 50 i Kushtetutës dhe neni 51 i Rregullores, lihet mundësia për interpretimin e termit “qytetar” në dy kontekste: së pari, vetëm “qytetar” i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ose edhe një i huaj, duke e pasur parasysh se sipas nenit 110, alineja 3 e Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese i mbron liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit, dhe së dyti, a ka mundësi personi juridik, përkatësisht një grup personash, të paraqesin kërkesë për mbrojtje.

Gjykata Kushtetuese, me Aktvendim U.nr.29/2002 të datës 13.3.2002, e hodhi poshtë kërkesën për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të një të huaji, por jo sepse parashtruesja ishte person i huaj, përkatësisht nuk ishte qytetare e Republikës së Maqedonisë, por meqë ka vlerësuar se “nuk është kompetente për të vendosur për shumën që parashtruesja duhet ta paguajë në emër të taksës për pranimin në shtetësi të Republikës së Maqedonisë.” Konsiderojmë se ky aktvendim vë në dukje se Gjykata Kushtetuese nuk do të refuzonte kompetencë për mbrojtjen e një të huaji, për shembull, nëse i është shkelur liria e shprehjes publike.

Lidhur me çështjen e dytë, Gjykata Kushtetuese i hodhi poshtë kërkesat e shoqërive tregtare si persona juridikë (U.nr.313/2020 04.2.2021 hidhet poshtë kërkesa e GEO SOLAR SHPK nga Dellçeva për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave që kanë të bëjnë me ndalimin e diskriminimit mbi bazë të përkatësisë sociale, të përcaktuara në nenin 110, alineja 3 të Kushtetutës).

Gjykata, veç tjerash, i hedh poshtë kërkesat e grupit fetar ose shoqatës së gazetarëve, me arsyetimin se vetëm qytetari, në emër dhe për llogari të tij, mund të jetë parashtrues i kërkesës. Së këtejmi, me Aktvendimin U.nr.182/2009 të datës 9.9.2009 Gjykata e hodhi poshtë kërkesën e një personi, si anëtar i një grupi fetar për mbrojtjen e lirisë së besimit, me pretendimin se kjo liri është shkelur me aktin e gjykatës kompetente, duke e refuzuar kërkesën për regjistrimin e atij grupi fetar, sipas ligjit, me arsyetimin se parashtruesja e kërkesës nuk kërkon mbrojtje personale nga diskriminimi i kryer me shkeljen e nenit 110, alineja 3 e Kushtetutës, por e njëjta është parashtruar në emër të të ashtuquajturit grup fetar të cilit i përkiste." Me të njëjtin arsyetim, me Aktvendimin U.nr.27/2013 datë 16.4.2014 Gjykata e hodhi poshtë kërkesën për mbrojtjen e lirisë së shprehjes së gazetarëve, të shkelur, duke i penguar të raportojnë për incidente në Kuvend, sepse ajo u parashtrua nga Shoqata e Gazetarëve të Republikës së Maqedonisë, e përfaqësuar nga Kryetari i saj. Me Aktvendimin U.nr.50/2017 datë 16.11.2017. Gjykata e hodhi poshtë edhe kërkesën e Shoqatës së Pensionistëve dhe Invalidëve të Komunës së Vrapçishtit, për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, që kanë të bëjnë me lirinë e asocimit dhe ndalimin e diskriminimit mbi bazë të përkatësisë sociale, sepse një kërkesë të tillë mund të parashtrrojë vetëm qytetari por jo edhe personi juridik.

Nga ana tjetër, me Vendimin U.nr.24/2012 datë 20.11.2012 Gjykata e pranoi kompetencën për të vendosur mbi kërkesën e Bashkësisë Fetare Bektashiane (në fazë themelimi) për mbrojtjen e të drejtës së mos diskriminimit mbi bazë të përkatësisë fetare, të shkelur me refuzimin e regjistrimit të saj, por e refuzoi, me gjetjen se nuk kishte shkelje.

Këto janë raste kur bëhet fjalë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, që kanë aspekte kolektive, siç janë liria e fesë (“Garantohet ..individualisht ose në bashkësi me të tjerët, shprehja e besimit.” – Neni 19 i Kushtetutës) dhe liria e organizimit dhe veprimit politik, të mbrojtur nga Gjykata Kushtetuese në përputhje me nenin 110 të Kushtetutës. Në këtë kontekst, regjistrimi i një grupi fetar është vetëm një nga aspektet e lirisë së mendimit, besimit dhe shprehjes publike të mendimit dhe nga ky aspekt grupi fetar, njëjtë si edhe partia politike, nga aspekti i lirisë së organizimit dhe veprimit politik ose një shoqate qytetarësh, anëtarët e së cilës vuajnë trajtime të ndryshme për shkak të statusit të tyre, mund të legjitimoheshin si parashtrues të kërkesës për mbrojtjen e të drejtave para Gjykatës Kushtetuese.

Për dallim nga trajtimi i Gjykatës Kushtetuese ose pranimit i saj, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut interpreton Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në kuptimin që çdokush mund të kërkojë mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me nenin 1 të Konventës.

## ***Kundër cilit akt mund të parashtrohet kërkesë për mbrojtje?***

Për një periudhë të gjatë është interpretuar dispozita e nenit 51, sipas së cilës mbrojtja e lirive dhe të drejtave mund të kërkohej kundër “aktit të veçantë përfundimtar ose të formës së prerë”, që do të thotë se kërkesa mund të ngrihet ose kundër një akti përfundimtar, që konsiderohet se i shkel liritë dhe të drejtat, i miratuar në një procedurë të zhvilluar nga organe të caktuara që vendosin për të drejtat e qytetarëve, pa kërkuar paraprakisht mbrojtje gjyqësore kundër tij ose duke kërkuar mbrojtje, pasi ai akt të bëhet i formës së prerë pas një procedure të zhvilluar gjyqësore. Në këtë kuptim, kërkesa për mbrojtje nuk është subsidiare, përkatësisht nuk është e nevojshme të absolvohej të gjitha mjetet juridike kundër aktit me të cilin është kryer shkelja e lirive dhe të drejtave kushtetuese. Mbrojtja para Gjykatës Kushtetuese është drejtpërdrejt kundër aktit me të cilin është kryer shkelja. Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese, edhe në periudhën e hershme të ushtrimit të kësaj kompetence, i trajtonte dhe merrte vendime lidhur me kërkesat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, të paraqitura kundër një akti përfundimtar, megjithëse procedura gjyqësore kundër këtij akti ishte në rrjedhë e sipër (U.nr.16/1992, datë 16.11.1994). Në një rast tjetër, Gjykata e hodhi poshtë kërkesën kundër një akti përfundimtar të një ndërmarrjeje për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kundër të cilit në rrjedhë e sipër ishte procedura gjyqësore, por si jo në kohën e duhur, sepse nga artikulli i aktit përfundimtar, kishin kaluar më shumë se dy muaj, dhe jo sepse ishte në rrjedhë e sipër procedura gjyqësore (aktvendimi U.nr.43/1999 datë 7 prill 1999).

Megjithatë, në vitet e fundit, Gjykata Kushtetuese, me sa duket, po zhvillon qëndrimin se, përkundrazi, kërkesa për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave mund të paraqitet vetëm pas absolvimit të të gjitha mjeteve juridike të aktit me të cilin është bërë shkelja. Kështu, në aktvendimin U.nr.131/2018 të datës 25.9.2019 Gjykata thekson se “adresimi i kërkesës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, pa veprime paraprake nga një gjykatë kompetente, ka të bëjë me rastet e shkeljes së lirisë ose të drejtës së njeriut dhe të qytetarit, të kryera nga një akt ose veprim i veçantë, në rastin kur shkeljet e kryera nga një akt ose veprim i veçantë i autoriteteve dhe institucioneve shtetërore, organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe organizatave me kompetenca publike, nuk janë parashikuar, ose kur nuk ka mjete të tjera efikase juridike për mbrojtjen e tyre. Në rastin konkret, për çështjen e ngritur me kërkesën, legjislacioni vendas parashikon mjete efikase juridike, të tilla si padia për mbrojtjen nga diskriminimi para një gjykate kompetente, para së cilës, në një procedurë të bazuar në parimet e prioritetit dhe urgjencës, çdokush mund të kërkojë mbrojtjen e lirisë ose të drejtës së shkelur, si dhe mbrojtjen nga diskriminimi.... Nga ky aspekt, kërkesa në Gjykatën Kushtetuese kualifikohet si ‘kërkesë e paraqitur para kohe për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave’, duke e pasur parasysh se instrumenti ‘mbrojtja e lirive dhe të drejtave para Gjykatës Kushtetuese’ është i natyrës subsidiare, ndërkaq mbrojtja subsidiare nënkupton absolvimin paraprak të të gjitha mjeteve të rregullta juridike në dispozicion të kërkuarit për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, duke e përfshirë edhe respektimin e afateve në të cilat pastaj kërkohej procedimi para Gjykatës Kushtetuese, në përputhje me nenin 51 të Rregullores së Gjykatës”.

E njëjta qasje shihet edhe në aktvendimet U.nr.109/2019, të datës 13.11.2019, U.nr.4/2020 të datës 3.6.2020, U.nr.250/2020 të datës 12.11.2020

Jemi të mendimit se kjo është një praktikë në kundërshtim me rregullin e nenit 51 të Rregullores dhe se do të prolongohet në mënyrë të paarsyeshme qasja e qytetarëve në Gjykatën Kushtetuese për të mbrojtur liritë dhe të drejtat që shkelen me akte përfundimtare në procedurat administrative. Kontestimi i këtyre akteve përpara një gjykate administrative ose të rregullta ka një përfshirje tjetër, të përcaktuar me ligjin përkatës, i cili kryesisht ka të bëjë me kontestin për ligjshmërinë, përkatësisht për zbatimin e ligjit, me efekte mbi të drejtat ligjore. Për shembull, gjykatat e rregullta e mbrojnë të drejtën e mos diskriminimit të përcaktuar në Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërsa Gjykata Kushtetuese siguron mbrojtjen e të drejtës kushtetuese për mos diskriminim dhe për këtë arsye, në Rregullore, i është lënë qytetarit të vendosë se a do ta kontestojë para Gjykatës Kushtetuese aktin përfundimtar me të cilin i është shkelur e drejta ose do të zhvillojë edhe procedurë gjyqësore kundër tij<sup>5</sup>.

5 Shih rastin Memedova dhe të tjerët kundër Maqedonisë së Veriut, aplikimi nr. 42429/16 (aktgjykimi i datës 24 tetor 2023).

## ***Mbajtja e Seancës dëgjimore publike***

Edhe pse sipas nenit 55 të Rregullores për kërkesat për mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave, Gjykata Kushtetuese vendos, sipas rregullit, në bazë të Seancës dëgjimore publike, megjithatë në praktikë ky rregull funksionon më shumë si përjashtim. Nga 55 raste për të cilat gjykata ka marrë vendim lidhur me kërkesat, Seanca dëgjimore publike është zhvilluar në 10 deri në 12 raste, nga të cilat 6 janë pas vitit 2017. Kjo e fundit me sa duket është rezultat i aktgjykimit të GJEDNJ-së në rastin ‘Selmani kundër Republikës së Maqedonisë’ të vitit 2017, në të cilin u konstatua shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së sepse Gjykata Kushtetuese nuk mbajti Seancë dëgjimore publike kur vendosi për kërkesën për mbrojtjen e lirisë së shprehjes së z. Selmanit dhe gazetarëve të tjerë, ndërsa Gjykata Kushtetuese ishte autoriteti i parë dhe i fundit me kompetenca gjyqësore para së cilës palët e interesuara kishin mundësi ta paraqesin rastin e tyre dhe t'i prezantojnë faktet relevante për vendimmarrje.

## ***Veprimi juridik i vendimit***

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 56 të Rregullores, në vendimet me të cilat ka konstatuar shkelje të lirisë apo të së drejtës, deri në vendimin e fundit të vitit 2023, i ka anuluar aktet e veçanta me të cilat është kryer shkelja, pavarësisht nëse ato kanë qenë akte të organeve administrative apo gjykatave. Së këtejmi, në Vendimin U.nr.84/2009 të datës 10.2.2010, Gjykata e anuloi Aktvendimin përfundimtar dhe të formës së prerë nr. 01-31/2 të datës 6 shkurt 2008, miratuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve – Zajas, me të cilin u refuzua kandidatura. Në lëndën U.nr.57/2019, Gjykata anuloi dy aktvendime të Gjykatës Themelore Shkup dhe një aktvendim të Gjykatës së Apelit në Shkup, me të cilat u dënuan avokatët. Në vendimin U.nr.230/2020 u anuluan aktvendimet si vijon:

- Aktvendimi nr. 02-200/2 datë 19.7.2018 i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Aktvendimi USPI nr.10/2019 datë 16.10.2019 i Gjykatës Administrative të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe
- Aktvendimi USPIZh. nr.17/2019, datë 6.5.2020, i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me të cilin u refuzua kërkesa për pezullimin e funksionit të gjyqtarit.

Në këtë lëndë, gjyqtari Osman Kadriu veçoi mendimin e tij<sup>6</sup>, duke deklaruar se "në kushtet kur me vendim gjyqësor do të përcaktohet se është shkelur një e drejtë ose liri konkrete, për të cilat jepet mbrojtje kushtetuese-gjyqësore, ndërsa raste të tilla ka pasur dhe do të ketë, Gjykata Kushtetuese duhet, me vendim deklarativ, ta konstatojë shkeljen në fjalë. Sipas kësaj, kompetenca e Gjykatës Kushtetuese realizohet, sendërtohet. Procedura e mëtejshme për fatin e vendimit të gjyqësorit të rregullt është në kompetencën e gjyqësorit të rregullt. Gjykata e rregullt, duke vepruar sipas konstatimeve të Gjykatës Kushtetuese, do të jetë e detyruar të veprojë për të njëjtat dhe të shmangë pasojat nga vendimi i këtillë. Të anulohet ose shfuqizohet vendimi i gjykatës së rregullt, nga Gjykata Kushtetuese, ndërkaq një dispozitë të tillë nuk përmban as Kushtetuta dhe as Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese."

Duhet ta vëmë në dukje se Rregullorja përmban një dispozitë të përgjithshme se Gjykata Kushtetuese do ta anulojë aktin e veçantë me të cilin është kryer shkelja, madje edhe vendimin gjyqësor, nëse me të njëjtin shkelet liria ose e drejta.

Ky qëndrim i mendimit të veçuar shkakton ndarje evidente në përbërjen e Gjykatës, sepse në vendimin e fundit U.nr.146/2021, Gjykata konstatoi se, me Aktgjykimin MALVP-705/20 të datës 14.4.2021 të Gjykatës Themelore Civile Shkup dhe Aktgjykimin GZh-2666/21 të datës 30.9.2021, të Gjykatës së Apelit Shkup, është shkelur liria e shprehjes publike të mendimit, megjithatë nuk i ka anuluar këto aktgjykime. Në vendimin theksohet "Duke e pasur parasysh se nuk janë plotësuar kushtet e nenit 112, paragrafi 2 të Kushtetutës, Gjykata nuk e pranoi kërkesën e parashtruesit për anulimin e Aktgjykimit MALVP-705/20 të datës 14.4.2021 të Gjykatës Themelore Civile Shkup dhe Aktgjykimit GZh-2666/21 të datës 30.9.2021 të Gjykatës së Apelit Shkup."

Është i çuditshëm referimi në nenin 112, paragrafin 2 të Kushtetutës, sepse ajo dispozitë ka të bëjë me anulimin ose shfuqizimin e akteve të përgjithshme normative, dhe jo me anulimin e akteve të veçan-

6 Mendimi i veçuar i gjyqtarit Osman Kadriu për lëndën U.nr.230/2020, <https://ustavensud.mk/?p=20406>

ta, me të cilat është bërë shkelje e të drejtave të nenit 110, alineja 3. Nga mendimi i veçuar i gjyqtarëve për këtë lëndë, mund të kuptohet se propozimi për anulimin e aktgjykimeve nuk ka marrë shumicën e nevojshme dhe cilat ishin qëndrimet e kundërta në lidhje me pyetjen se Gjykata Kushtetuese a mund ta anulojë vendimin e një gjykate të rregullt. Megjithatë, as në vendimin, dhe as në mendimin e veçuar nuk mund të shihet ndonjë shpjegim për referimin në nenin 112, paragrafin 2 të Kushtetutës.

Duke e pasur parasysh faktin se kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit është e pakushtëzuar, si dhe faktin se Rregullorja e parashikon anulimin e detyrueshëm të aktit të veçantë me të cilin është kryer shkelja, përjashtimi i vendimit gjyqësor nga efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, duket qartë se nuk ka asnjë shpjegim të arsyeshëm. Nëse është e pakontestueshme se Gjykata Kushtetuese, me vendim, përcakton shkelje të lirive dhe të drejtave, kur një gjë e këtillë bëhet me vendim gjyqësor, atëherë nuk mund të kuptohet pse Gjykata është e përmbajtur sa i përket anulimit të vendimit, siç e kërkon formalisht Rregullorja.

Mbetet e hapur pyetja nëse veprimi i këtillë i Gjykatës Kushtetuese e trajton çështjen e efikasitetit dhe efektivitetit të kërkesës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, apo e bën këtë nga aspekti teorik dhe deklarativ, që nuk është në përputhje me praktikën e mëparshme gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, dhe është në kundërshtim me Rregulloren, Kushtetutën dhe praktikën e GJEDNJ-së?

Ka hapësirë që Gjykata t'i interpretojë dispozitat kushtetuese dhe të Rregullores, në drejtim të një zgjerimi të mundshëm të fushëveprimit të kompetencës së saj, në vend që ta mbitheksojë kufizimin e autorizimeve të veta dhe t'i reduktojë efektet e vendimeve të saj mbi kompetencën tashmë të kufizuar për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

## Analiza e aspektit meritot të vendimeve

### Vendime me të cilat është përcaktuar shkelje

**U.nr.84/2009 datë 10.2.2010**

shkelja e lirisë së organizimit dhe veprimit politik

Vendimi, me të cilin për herë të parë Gjykata Kushtetuese konstatoi shkelje të lirisë dhe të drejtës, e pasqyron rëndësinë e interpretimit të lirive dhe të drejtave si kusht parësor për realizimin e kësaj kompetence. Në rastin në fjalë, Komisioni kompetent komunal i zgjedhjeve nuk e ka pranuar kandidaturën e parashtruesit të kërkesës, për shkak se ai ishte i regjistruar në regjistrat penalë të Ministrisë së Brendshme, edhe pse vepra paraprakisht është përfshirë me amnistinë. Edhe pse në rastet e mëparshme, kërkesat për mbrojtje në kontekstin e përcaktimit të listave të kandidatëve Gjykata i ka trajtuar si kërkesa për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes, për të cilën nuk është kompetente të vendosë (aktvendimet U.nr.169/1994 dhe U.nr.170/1994 datë 19.10.1994; U.nr. 160/2000 datë 15.11.2000; U.nr.55/2004 datë 31.3.2004) në këtë rast, pas Seancës së mbajtur dëgjimore publike dhe rishikimit të qasjes së saj, e vendosi standardin se refuzimi i kandidaturës në procesin zgjedhor është në kuadrin e përfshirjes së “lirisë së organizimit dhe veprimit politik”, për mbrojtjen e së cilës është kompetente të vendosë në përputhje me nenin 110, alinenë 3 të Kushtetutës dhe konstatoi shkelje të kësaj lirie në rastin në fjalë.

**U.nr.116/2017 datë 27.6.2018**

- shkelja e lirisë së mendimit dhe shprehjes publike
- diskriminim mbi bazë të përkatësisë politike

Në vendimin, Gjykata vlerësoi se pengimi i personave që të shfaqin një pankartë me parulla kundër shpenzimit të parave publike për armatim luftarak, nga policia, gjatë një prezantimi publik të pajisjeve luftarake, dhe arrestimi dhe largimi i personave - anëtarë të partisë politike “Levica”, të cilët i mbanin ato pankarta, përbën shkelje të mendimit dhe shprehjes publike të mendimit. Së këtejmi, Gjykata, në masë të madhe u mbështet në pikëpamjet e GJEDNJ-së, të artikuluar në praktikën e saj, në lidhje me nenin 10 dhe nenin 11 të KEDNJ-së dhe arriti në përfundimin se kufizimi i lirisë së shprehjes publike nuk nënkupton qëllim legjitim dhe nuk është i domosdoshëm në një shoqëri demokratike, duke e pasur parasysh atë se shfaqja e pankartave në një vend publik përbënte një protestë paqësore që nuk e prishi rendin dhe qetësinë publike.

Gjykata, njëkohësisht, përcaktoi se kishte shkelje të së drejtës për mos diskriminim mbi bazë të përkatësisë politike të këtyre personave, por vendimi nuk ofron asnjë shpjegim bindës se prej ku rezulton shkelja dhe si u identifikua komparatori ndaj të cilit është bërë diskriminim. Gjykata pranoi se këta persona janë trajtuar në mënyrë diskriminuese në raport me të gjithë personat e tjerë të pranishëm në ngjarje, të cilët nuk i kanë kundërshtuar mesazhet për rëndësinë e pajisjes së armatës me armë dhe të njëjtët nuk janë penguar ta artikulojnë pikëpamjen e tyre. Gjykata thekson se: “trajtimi diskriminues i pjesëtarëve të policisë, duke ndërmarrë forcë fizike, duke i prangosur dhe duke i privuar nga liria, në fakt e deklaroi institutin diskriminim me të gjitha tiparet e tij mbrojtëse dhe vendosjen e parashtruesve të kërkesës në një pozitë të palakmueshme, të pabarabartë, përkatësisht një trajtim të ndryshëm nga të gjithë të pranishmit në ngjarje, ku si komparator në situatën konkrete ishin ata që tregonin pajisje ushtarake dhe publikisht e artikulonin mendimin e tyre dhe nuk janë trajtuar në mënyrë më pak të favorshme dhe të ndryshme, dhe asnjë nga të drejtat e tyre civile nuk u kufizua, ndryshe nga rasti i aplikantëve.” Megjithatë, në vendim nuk ka të dhëna se edhe personat e pranishëm të tjerë mbanin pankarta ose artikulonin kritika negative dhe për këtë nuk vuajtën pasoja, ndërsa ishin anëtarë të partive të tjera politike, që do të ishin komparator në një rast të tillë si persona në situatë të njëjtë ose përfaqësues të njëjtë, që të pretendohet se janë trajtuar ndryshe mbi bazë të përkatësisë politike. Është më se problematike të merret si komparator shteti, përkatësisht pjesëtarët e organeve që e bënin prezantimin dhe të pretendohet se “ata që prezantuan pajisjet nuk u trajtuan në mënyrë më pak të favorshme”. Ose të pranishmit, pa kufizime, e panë dhe u pajtuan me mesazhin nga defileu. Ky “diskriminim” dhe argumentet për të njëjtin janë absolutuar në shkeljen e përcaktuar të lirisë së shprehjes. Me sa duket Gjykata mund t'i kishte kushtuar më shumë vëmendje praktikës së GJEDNJ-së me qëllim të vendosjes së standardeve në testin e diskriminimit, veçanërisht për identifikimin e komparatorit.

**Vendimi U. nr.57/2019 datë 29.5.2019**

shkelja e lirisë së shprehjes së avokatit

Në vendim, Gjykata pranoi se ndëshkimi i avokatëve, të cilët në kundërshtim me urdhrin e gjykatës, të ulen, duke qëndruar në këmbë në sallën e gjyqit, shprehën protestë për mos sigurimin e kushteve për punën e tyre në sallën e gjyqit (nuk kishte tavolina për ta, kështu që ata duhej të mbanin shënime “në gjunjë”), është shkelje e së drejtës së tyre për lirinë e shprehjes, e rëndësishme për përfaqësimin e interesave të klientëve të tyre, dhe nuk mund të konsiderohej vetëm si një sanksion për prishjen e rendit në sallën e gjyqit, por si një kufizim i së drejtës së tyre për kritikë. Edhe në këtë aktgjykim, Gjykata iu referua praktikës së GJEDNJ-së dhe vlerësoi se një kufizim i tillë i lirisë së shprehjes së avokatëve, e cila është e një rëndësie të veçantë, është jo proporcionale me qëllimin përndryshe legjitim të ruajtjes së rendit në sallën e gjyqit.

**Vendimi U.nr.230/2020 datë 12.11.2020**

- shkelja e të drejtës së jetës familjare
- diskriminim mbi bazë të përkatësisë sociale

Vendimi meriton vëmendje të veçantë, duke e pasur parasysh që Gjykata, në pikën 2 të dispozitivit, konstatoi shkelje të së drejtës për jetë private dhe familjare, sipas nenit 40 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së. Dëshirojmë t'ua bëjmë me dije se Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente për mbrojtjen e kësaj të drejte, madje nuk është kompetente as për të vendosur për shkelje të KEDNJ-së. Gjykata, sipas praktikës së saj, i interpreton liritë dhe të drejtat e specifikuar në Kushtetutë në dritën e praktikës së GJEDNJ-së, por formalisht i mbron vetëm të drejtat kushtetuese.

Në këtë rast, parashtruesja e kërkesës i ka kërkuar gjykatës të përcaktojë se është diskriminuar mbi bazë të përkatësisë sociale si gjyqtare, pasi i është refuzuar kërkesa për pezullimin e funksionit të gjyqtares për shkak të shoqërimit të bashkëshortit, i cili ishte zgjedhur gjyqtar i GJEDNJ-së, me mandat 9 vjeçar. Këshilli Gjyqësor vlerësoi se Ligji për Gjykatat nuk e ka parashikuar mundësinë e pezullimit të funksionit të gjyqtarit në situata të tilla, megjithatë ajo konsideron se kjo e drejtë rezultoi nga Ligji për Marrëdhëniet e Punës dhe duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë të punësuarit, duke i përfshirë edhe gjyqtarët.

Gjykata Kushtetuese, në pikën 1, specifikon: “merret në konsideratë kërkesa e personit për mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit nga neni 110, alineja 3 e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, që kanë të bëjnë me ndalimin e diskriminimit mbi bazë të përkatësisë sociale.”

Megjithatë, Gjykata nuk ka deklaruar se është përcaktuar shkelje e kësaj të drejte. Nuk është e qartë nëse Gjykata është e mendimit, që me deklaratën se merret në konsideratë kërkesa e parashtrueses, automatikisht ka përcaktuar shkelje, nuk mund ta dimë, por sidoqoftë mungesa e një dispozitivi të duhur të rregulluar me Rregulloren, është një lëshim i papranueshëm. Do të ishte më e lehtë të tejkalohet dispozitivi joadekuat se “kërkesa merret në konsideratë”, nëse Gjykata në një pikë të veçantë do të përcaktonte shkelje. Sipas kësaj, rezulton se Gjykata nuk ka vendosur fare për punë në kompetencë të saj, por megjithatë i ka anuluar aktet e Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatës Supreme.

Gjithashtu nuk mund të kuptohet pse Gjykata, pa bazë ligjore, është angazhuar në përcaktimin e shkeljes të së drejtës së privatësisë, për mbrojtjen e së cilës nuk është kompetente sipas nenit 110, alinesë 3 të Kushtetutës. Prandaj, parimisht nuk mund të analizohet asnjë pikëpamje e Gjykatës, të artikuluar në justifikimin, dhe të shqyrtohen doktrina të ndryshme ose standarde të arsytimit. Megjithatë, duhet të vihet në dukje një diskrapancë e caktuar në qasjen e Gjykatës ndaj GJEDNJ-së. GJEDNJ-ja, në mënyrë të përsëritur ka theksuar se kur vendos për shkeljen e së drejtës për mos diskriminim sipas nenit 14 të KEDNJ-së, këtë detyrimisht e bën në kontekstin e ushtrimit të ndonjë prej lirive dhe të drejtave të garantuara në KEDNJ, siç është e drejta e privatësisë dhe jetës familjare, sipas nenit 8. Megjithatë, diskriminimin e vlerëson pavarësisht nëse njëkohësisht ka edhe shkelje të atij neni material. Një kontekst i tillë i kufizuar nuk ekziston kur diskriminimi vlerësohet nga pikëpamja e nenit 1 të Protokollit nr.12 të KEDNJ-së. Gjykata Kushtetuese, në këtë rast, me sa duket e lidhi çështjen e diskriminimit, të cilit iu referua parashtruesja, me të drejtën e privatësisë dhe jetës familjare sipas nenit 40 të Kushtetutës, por në vend që të përqendrohej në çështjen e diskriminimit dhe të vendoste për të (në kontekstin e së drejtës për privatësi), ajo, në të vërtetë, e trajtoi të drejtën e privatësisë (konteksti është bërë çështja kryesore) dhe përcaktoi shkelje të asaj të drejte, edhe pse nuk është kompetente. Në këtë drejtim është e rëndësishme që Gjykata ta rishikojë qasjen e saj për hir të konsistencës në ushtrimin e kësaj kompetence. Së këtejmi, duhet të nënvizohet se, në situata të tjera, kur parashtruesi nuk kërkon mbrojtje të një të drejte sipas nenit 11 alinesë 3 ose kërkesa e parashtruar është e qartë, Gjykata i hedh poshtë kërkesat, kurse në këtë rast, edhe pse nuk ka kërkesë ose mund të ketë qenë e paqartë, Gjykata me iniciativën e saj angazhohet në shqyrtimin dhe veprimin.

**Vendimi 146/2021 datë 12.7.2023**

Shkelja e lirisë së shprehjes së gazetarit, mos përmbushja e detyrimit pozitiv të shtetit

Në vendimin, Gjykata Kushtetuese për herë të parë u mbështet në doktrinën e detyrimit pozitiv të shtetit në sigurimin e lirive dhe të drejtave, duke u mbështetur në praktikën e GJEDNJ-së. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës, gazetar me profesion, i cili gjatë ngjarjeve të dhunshme në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, në vitin 2017, u pengua të raportonte dhe ishte nën frikë dhe kërcënim për sigurinë e tij. Pastaj në një periudhë të caktuar kohore, ai paraqiti një padi në gjykatën civile duke kërkuar kompensim të dëmit jo material për shkak të shkeljes së lirisë së mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, me argumentin se shteti nuk e kishte përmbushur detyrimin e tij pozitiv për t'ia siguruar atë të drejtë, të garantuar specifikisht në nenin 10 të Konventës. Gjykatat civile në mënyrë të plotfuqishme e refuzuan kërkesë padinë e tij, duke vlerësuar se një interpretim i tillë i nenit 10 të Konventës, në lidhje me ekzistencën e detyrimit pozitiv, është i mundur vetëm në rrethana të rregullta për të cilat ka të bëjë ky nen, por jo edhe në ngjarje të këtilla të dhunshme. Gjykata Kushtetuese përcaktoi shkelje të lirisë së mendimit dhe shprehjes publike të mendimit të parashtruesit të kërkesës, sepse ka vlerësuar se ai, gjatë ngjarjeve të dhunshme të shkaktuara me hyrjen e turmës në ndërtesën e Kuvendit, nuk mundej t'i artikulojë idetë e tij pa frikë (në këtë kontekst, shteti nuk ia siguroi këtë të drejtë duke ndërmarrë masa të duhura për të qenë në gjendje të raportojë nga Kuvendi në një mënyrë që është e zakonshme për profesionin), ndërkohë që gjykatat përcaktuan se detyrimi i këtillë i shtetit, në këtë rast, nuk ekziston.

Përveç kritikës që e bëmë më sipër në këtë tekst, në pjesën e efikasitetit dhe efektivitetit (veprimi juridik i vendimeve) në lidhje me mungesën e dispozitivit në vendimin me të cilin do të anuloheshin të dy vendimet e gjykatave, ky vendim duhej të ishte më specifik në artikulimin e argumentit për mos përmbushjen e detyrimit pozitiv (jo vetëm që në ditën e ngjarjeve nuk u ndërморën masa, por edhe dy vendimet e gjykatave civile konsistojnë me mos përmbushjen e detyrimit pozitiv të shtetit në të gjithë kontekstin). Në të vërtetë, Gjykata, në dispozitivin, përcakton se e drejta e parashtruesit të kërkesës është shkelur me këto aktgjykime). Sublimimi i arsytimit në një fjali, se “ai nuk mund të shprehej pa frikë” është e pamjaftueshme për ta zbardhur konceptin e plotë të Gjykatës që qëndron pas këtij vendimi.

## **Vendime me të cilat është refuzuar kërkesa**

### ***Liria e mendimit dhe shprehja publike e mendimit***

Në disa raste, Gjykata i refuzoi kërkesat për mbrojtjen e kësaj lirie, të paraqitura nga avokatët që u ndëshkuan në sallë gjyqi për prishjen e rendit, duke gjetur se dënimi ishte i justifikuar, duke e pasur parasysh sjelljen e avokatit (për shembull, duke i ndërhyrë në fjalë një dëshmitari të mitur gjatë dhënies së deklaramit – U.nr.30/2021; me sjellje ironike në lidhje me drejtimin e seancës – U.nr.105/2019 dhe të tjera). Në raste të tilla, Gjykata ka vlerësuar se avokati është dënuar për sjellje joprofesionale në sallën e gjyqit, dhe jo për artikulin e pikëpamjeve dhe opinionëve të tij). Në një rast tjetër, Gjykata nuk pranoi që kritika për sjelljen e palës kundërshtare dhe gjendjen në disa nga kontestet e tyre të tjera, me ç'rast aplikanti konsideroi se ka ndikim mbi vlerësimin e ndërjegjes së tyre në rastin konkret, bën pjesë në mbrojtje të nenit 16 të Kushtetutës – U. nr.107/2010). Në të gjitha këto raste, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së, me ç'rast aspekti vendimtar konsiston, si edhe në rastin kur përcaktoi shkelje të lirisë së shprehjes së avokatëve (shih më lart!), me atë që Gjykata të përcaktojë se çfarë funksioni dhe çfarë efektësh kishte artikulli për të cilin avokati u dënua. Konsistenca e vendimmarrjes gjithsesi se u jep kredibilitet vendimeve.

Një tjetër grup i rëndësishëm vendimesh me të cilat janë refuzuar kërkesat për mbrojtjen e lirisë së shprehjes/artikulimit, janë ato që kanë të bëjnë me rastet, për të cilat GJEDNJ-ja më vonë miratoi aktgjykime të kundërta. Vendime të këtilla janë: U.nr. 164/2014 datë 14.10.2015, në të cilin Gjykata i refuzoi kërkesat e gazetarëve kundër aktgjykimeve të gjykatave civile, me të cilat i kanë shpallur përgjegjës për shpifje dhe kanë kërkuar t'i paguajnë paditësit, një zyrtar i rangut të lartë, shuma të larta dëmshpërblimi (GJEDNJ me aktgjykimin 38549/16 datë 5.4.2022, kur konstatoi se gazetarët “kanë shkruar me kujdesin e kërkuar nga gazetarët gjatë raportimit për çështje me interes publik”); U.nr. 27/2013 datë 16.4.2016, në të cilin Gjykata e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e lirisë së shprehjes, të shkelur me nxjerrjen jashtë të gazetarëve nga galeria e Sallës plenare të Kuvendit – GJEDNJ me aktgjykimin 67259/14 datë 9.2.2017 ka konstatuar se ka pasur shkelje; U. nr.3/2012 datë 2.5.2012, kur Gjykata e refuzoi kërkesën e një gazetari, i cili ishte dënuar për veprën penale shpifje për shprehjen e tij në një tekst gazetaresk për një gazetar tjetër dhe për Qeverinë –GJEDNJ me aktgjykimin 28032/12 datë 8.10.2020 konstatoi se aplikanti ka artikuluar qëndrime vlerash për pushtetin dhe mbështetësit e tij dhe se dënimi penal e rrezikon debatin publik në vend dhe ka efekt retrograd; U.nr. 155/2011 datë12.9.2012 dhe U.nr.146/2010 datë 23.2.2011 Gjykata refuzoi dy kërkesa për mbrojtje, të parashtruara nga zëdhënësi i një partie politike, i cili ishte i dënuar për dy vepra penale-shpifje, për shkak të artikullimit në pres-konferencë pyetje për involvimin e mundshëm të një zyrtari të rangut të lartë në transaksione të caktuara për parcela për ndërtimin e hotelit në qendër të Shkupit, si dhe për përdorimin e mundshëm sekret të të dhënave nga bursa-GJEDNJ me aktgjykimin 64659/11 dhe 24133/13 të datës 19.7.2018, konstatoi, në kundërshtim me Gjykatën Kushtetuese, se në të dyja rastet ka pasur shkelje, sepse aplikanti ishte i dënuar për fjalim politik për çështje me interes publik. Kjo qasje e ndryshme e Gjykatës Kushtetuese, në raport me GJEDNJ, sa u përket instancave jashtëzakonisht serioze të lirisë së shprehjes, është shqetësuese.

Në sferën e lirisë së shprehjes fetare, Gjykata Kushtetuese, me vendimin U.nr.24/2012 të datës 20.11.2012, e refuzoi kërkesën e Bashkësisë Fetare Bektashiane dhe disa individëve për mbrojtjen e lirisë fetare dhe mbrojtjen e së drejtës për mos diskriminim mbi bazë fetare, të shkelur me refuzimin e regjistrimit të bashkësisë fetare. Regjistrimi u refuzua nga gjykatat për shkak se emërtimi “Bektashiane” përmbahej në emërtimin e një grupi tjetër fetar dhe se aspekti identik i burimeve të mësimëve të dy bashkësive mund të shkaktonte konfuzion dhe përçarje të pajustificuara të besimtarëve, të cilat Gjykata i konsideroi të justifikuara, dhe nuk gjeti asnjë shkelje të lirisë së fesë ose të së drejtës për mos diskriminim – ndërkaq GJEDNJ-ja, me aktgjykimin 48044/10 75722/12 dhe 25176/13 të datës 12.4.2018, vendosi që refuzimi i regjistrimit, përkundrazi, e ka shkelur lirinë e besimit fetar, në kontekstin e së drejtës së shoqërimin, kurse autoritetet vendase nuk treguan se refuzimi i regjistrimit përmbushte ndonjë qëllim legjitim me interes publik.

Gjykata Kushtetuese i refuzon kërkesat për mbrojtjen e lirisë së shprehjes kur parashtruesi kërkon mbrojtje në rastet kur ai është penalizuar për deklarata të pavërteta ose ofenduese (U.nr.319/2020, U.nr.117/2012, U.nr.147/2011). Së këtejmi, Gjykata e vlerësoi kufirin e lirisë së shprehjes në rrethanat dhe faktet specifike të çështjes dhe i balancoi interesat kontradiktore. Në këtë kontekst, Gjykata,

me vendimin 50/1998, e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e lirisë së shprehjes publike të kryetarit të Komunës së Gostivarit, i cili u dënua penalisht sepse në një tubim publik bëri thirrje për mosrespektimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, dhe me deklaratat e tij nxiti intolerancë kombëtare, duke vlerësuar se deklaratat të tilla nuk janë përfshirë me lirinë e shprehjes në një shoqëri demokratike. Nga ana tjetër GJEDNJ-ja, me vendimin 50841/99, datë 11.10.2001, aplikimin e parashtruesit e shpalli si të papranueshëm. Në raste të tjera, duke i pasur parasysh disa mendime të veçuara të gjyqtarëve, Gjykata me sa duket ndonjëherë shumë ngushtë i vendos kufijtë e artikulimit provokues në një debat intelektual, pavarësisht nga konteksti dhe prapavija e shprehjes publike, dhe lehtësisht e pranon ekzistencën e fryerjes, si edhe gjykatat e rregullta, atje ku madje vetëm shprehja është më e fortë (shih Ubr.147/2011).

Me vendimin U.nr.220/1999, Gjykata Kushtetuese e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e lirisë së bindjes të një personi, i cili është deklaruar si mysliman, për ta arsyetuar mungesën nga puna gjatë një feste fetare për pjesëtarët e besimit fetar islam, dhe për këtë shkak atij i është shqiptuar ndërprerja e marrëdhënies së punës. Gjykata zhvilloi një Seancë dëgjimore publike gjatë së cilës përcaktoi nëse bindjet e pretenduara të parashtruesit ishin burimore dhe të vërteta apo ai thjesht iu referua atyre për arsye evidente praktike. Gjykata vlerësoi se parashtruesi nuk ka njohuri elementare për besimin fetar të cilit i referohet, që është e nevojshme për t'iu referuar të drejtës së mungesës nga puna mbi atë bazë. GJEDNJ-ja, megjithatë, me aktgjykimin 55170/00 datë 13.4.2004, u pajtua me gjetjet e Gjykatës Kushtetuese dhe vlerësoi se, për të përfituar nga privilegji i mungesës në punë për arsye fetare, nuk është jo proporcionale të kërkohet që ai të dëshmojë një nivel të caktuar të përkatësisë ndaj fesë të cilës i referohet.

Në vendimin U.nr.86/2018, Gjykata vlerësoi se e drejta e lirisë së shprehjes publike të pesë personave nuk është shkelur me veprimin e ndërmarrë nga policia për shmangien e barrikadës me sendet që ata i vendosën në segmentin rrugor para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sepse policia përmbushi detyrimin e tyre ligjor për të siguruar funksionimin e segmentit rrugor, por kjo nuk e pengoi grupin që edhe më tej të artikulonte dhe të brohoriste parullat e tij anti-qeveritare para Kuvendit.

Në vendimin U.nr. 168/2001, Gjykata e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e lirisë së shprehjes publike të një personi, të cilit një gazetë e përditshme refuzoi të publikonte disa shpallje për të komunikuar idetë dhe pikëpamjet e tij mbi realitetin shoqëror. Gjykata vlerësoi se bëhet fjalë për zgjedhje të lirë të subjektit ekonomik se si do të veprojë në çdo situatë specifike, që është në kuadër të lirisë së tregut dhe sipërmarrësisë, dhe se për situatën të tilla nuk mund të ketë asnjë detyrim për subjektin ekonomik që të duhet të publikojë idetë e qytetarëve në planin personal dhe shoqëror.

Me vendimin U. nr.333/1995, Gjykata e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e lirisë së shprehjes të një përfaqësuesi të sindikatës në Kombinatin “Teteks” në Tetovë, të cilit i ishte shqiptuar ndërprerja e marrëdhënies së punës për shkak të deklaratave në gazetën “Fokus”, me të cilat pretendohet se e ka paraqitur në mënyrë jo të vërtetë situatën në kombinat. Në aktin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës theksohet se personi e ka prishur rendin e punës, është larguar nga vendi i punës, ka agjitur për persona të tjerë dhe ka mbledhur nënshkrime pa autorizim dhe nuk i ka kryer detyrat e tij të punës. Gjykata Kushtetuese i pranoi këto pretendime, megjithatë, në vendimin, Gjykata nuk hyri fare në vlerësimin e aktiviteteve të tij, përmbajtja e intervistës në Fokus nuk është paraqitur dhe nuk mund të shihet se cilat janë deklaratat kontestuese; përkatësisht, Gjykata vetëm përgjithësisht i referohet faktit se liria e shprehjes është absolute dhe se nëse ajo liri tejkalohet, mund të ketë pasoja. Megjithatë, Gjykata nuk tregon se në cilën mënyrë parashtruesi e tejkaloi lirinë e shprehjes. Gjykata, si rrethanë rënduese, e mori faktin se parashtruesi ishte një aktivist sindikalist, në vend që ta merrte si një faktor që e vë atë në pozitë të hapë çështje problematike me të punësuarit dhe punëdhënësin. Veç tjerash, Gjykata nuk zhvilloi Seancë dëgjimore publike për ta dëgjuar qëndrimin e tij dhe të punëdhënësit, t'i ofrojë mundësi që t'i paraqesë provat në favor të tij, si dhe t'i marrë në pyetje dëshmitarët për të vërtetuar faktet që çuan në pasoja kaq drastike – ndërprerje të marrëdhënies së punës. Në pjesën përfundimtare të vendimit, Gjykata thekson se parashtruesi nuk është penguar të japë intervistë në gazetë, por se ndërprerja e marrëdhënies së punës ka ndodhur si pasojë e përmbajtjes së intervistës. Megjithatë, mbrojtja e lirisë së shprehjes nuk mund të reduktohet në mundësinë e shprehjes së mendimit, por të mos ndëshkohet për atë që e ka shprehur, nëse kjo nuk synon shkeljen e të drejtave të të tjerëve ose shkeljen e një interesi serioz publik. Me sa duket nga pikëpamja e praktikës së GJEDNJ-së, qasja e këtillë është e një rëndësie thelbësore.



Me vendimin U.nr.16/1992 datë 16.11.1994, Gjykata e refuzoi kërkesën e dy punonjësve të Elektroekonomisë së Maqedonisë, për mbrojtjen e lirisë së mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, të shkelur me vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së tyre të punës, sepse ata shprehën dyshime në shtypin e përditshëm për besueshmërinë e Bilancit Energjetik për një vit të caktuar. Këto dyshime i kishin artikulluar edhe paraprakisht në kompani. Gjykata vlerësoi se nuk ka pasur shkelje të lirisë së shprehjes, pasi këta punonjës i kanë shkelur rregullat e brendshme të kompanisë, të cilat nuk lejojnë çështjet në lidhje me veprimtarinë e kompanisë të artikuloohen publikisht. Nga pikëpamja e praktikës së GJEDNJ-së, edhe ky vendim është dukshëm problematik.

Në vendimin U.nr.39/1992 datë 23.12.1992, Gjykata e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e lirisë së shprehjes së një qytetari, të shkelur me heqjen e pasaportës në një vendkalim të vogël kufitar sepse, kur ishte në Bullgari, ka thënë se maqedonasit janë bullgarë. Gjykata vlerësoi se ky sanksion ishte i justifikuar, sepse i ka shkelur të drejtat e të tjerëve (maqedonasve) për vetëpërcaktim, dhe pastaj deklaroi se nuk i ishte kufizuar e drejta për t'u shprehur, as nuk ishin marrë masa diskriminuese ndaj tij për shkak të përkatësisë së tij kombëtare, as për arsye të tjera. Në fund, Gjykata specifikoi se nuk është kompetente të vendosë për lëshimin dhe heqjen e dokumenteve të udhëtimit. Në këtë vendim, incidenti krijoi jo konsistencë të justifikimit, i cili tregohet veçanërisht në konstatimin se ndaj parashtruesit nuk janë marrë masa diskriminuese mbi bazën e përkatësisë kombëtare të tij, as mbi ndonjë baze tjetër. Megjithatë, qëndron fakti se i është hequr dokumenti i udhëtimit për shkak të artikullimit të mendimit se nuk ekzistojnë maqedonas. Gjykata, në dispozitivin, vendosi se me këtë nuk i është shkelur liria e mendimit, bindjes dhe shprehjes publike të mendimit, kështu që është e paqartë pse argumentohet çështja e mosekzistimit të diskriminimit, kur parashtruesi as që i referohet kësaj të drejte. Në vend që kontekstin ta vendosë mbi heqjen e dokumentit të udhëtimit për shkak të mendimit të shprehur dhe të argumentojë përse heqja e dokumentit të udhëtimit, për shkak të mendimit të shprehur, nuk përbën shkelje, Gjykata, me një justifikim jo konsistent, krijon përshtypjen sikur ndaj parashtruesit nuk janë ndërmarrë kurrfarë masash. Së fundi, është e paqartë se në çfarë funksioni është pretendimi se Gjykata nuk është kompetente të vendosë për heqjen e dokumenteve të udhëtimit.

Në bazë të rasteve dhe komenteve të mësipërme, me sa duket në funksionimin e Gjykatës nevojitet identifikim më i kujdesshëm i natyrës së kufizimit (sanksionimi i mendimi të shprehur) në një kontekst të caktuar dhe, nëse kërkesa refuzohet, nevojitet një argumentim më bindës në lidhje me atë nëse dhe pse në raste të caktuara u tejkalua liria e shprehjes që e justifikon sanksionin .

### ***Liria dhe e drejta e organizimit dhe veprimit politik***

Në vendimin U. nr.27/1994, Gjykata vlerësoi se nuk ka pasur shkelje të organizimit dhe veprimit politik, kur u shqiptua ndalimi i një partie politike, veprimtaria e së cilës përdoret për të nxitur urrejtje dhe intolerancë kombëtare, siç është përcaktuar nga Gjykata Supreme. Gjykata vlerëson se neni 20 i Kushtetutës e përcakton bazën për ndalimin e punës së partive politike, të cilat veprimtarinë e tyre e përqendrojnë në nxitjen e urrejtjes dhe intolerancës kombëtare, fetare dhe racore, si një mënyrë e abuzimit me lirinë kushtetuese të organizimit dhe veprimit politik, dhe se në rastin konkret, me aktgjykimin e kontestuar, nuk kufizohet liria përkatëse e organizimit dhe veprimit politik të anëtarëve të partisë në fjalë, por që e njëjta liri mbrohet për qytetarët e tjerë të Republikës së Maqedonisë.

Gjykata vlerësoi se nuk ka pasur shkelje të kësaj të drejte dhe në rastin kur Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me Konkluzion, e refuzoi nismën qytetare për shpalljen e referendumit për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, sepse vlerësoi se, me paraqitjen e nismës nga ana e qytetarëve për shpalljen e referendumit për zgjedhje të parakohshme, iu mundësua të veprojnë politikisht mbi pushtetin, përkatësisht mbi Kuvendin - si bartës i pushtetit legjislativ, i cili, në kuadër të mundësive kushtetuese kishte mundësi, nëse kështu do të vlerësonte shumica e nevojshme, ta shpërndajë Kuvendin dhe të shpallë zgjedhje të parakohshme.

Duke e marrë parasysh këtë që u tha më sipër, Gjykata vlerësoi se me konkluzionin e kontestuar nuk shkelet liria e qytetarëve për t'u shoqëruar dhe për të vepruar politikisht. Gjykata, mes tjerash, vlerësoi se me konkluzionin e kontestuar, parashtruesve të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese – nënshkrues të nismës për shpalljen e referendumit për zgjedhje të parakohshme, nuk u është kufizuar liria për t'u shoqëruar dhe për të vepruar politikisht, por me këtë konkluzion artikullohet vetëm qëndrimi i Kuvendit se

nuk ka bazë kushtetuese për shpalljen e referendumit për zgjedhje të parakohshme, sepse Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë nuk ka parashikuar një mundësi të tillë (U. nr. 160/1994, datë 18.12.1996).

## **Diskriminimi**

### **• mbi bazë të përkatësisë sociale**

Vendimet me të cilat refuzohen kërkesat për mbrojtjen e së drejtës për mos diskriminim për shkak të përkatësisë sociale dominohen nga vendimet në të cilat parashtruesit e kërkesave u referohen rrethanave irelevante për identifikimin e trajtimit të ndryshëm mbi këtë bazë. Kështu, shpeshherë, nga Gjykata Kushtetuese kërkohet të përcaktojë diskriminim mbi bazë të përkatësisë sociale nga njëra prej palëve në kontestet civile, të cilat deklarojnë se Gjykata ka miratuar aktgjykim në dëm të tyre, sepse e ka favorizuar palën e kundërt "më të fortë" ose "më të pasur" (U.nr.137/2021, U.nr.84/2021, U.nr.85/2019, U.nr.2014/2000). Në raste të tjera, parashtruesve të kërkesës ose u kanë skaduar afatet për t'i realizuar të drejtat e tyre – e drejta e blerjes së apartamentit (U.nr. 57/2000) ose nuk kanë paraqitur prova për realizimin e të drejtës për ndihmë juridike falas (U.nr. 39/2012), ndërsa para Gjykatës pohonin se janë diskriminuar mbi bazë të përkatësisë sociale.

Në vendimin U. nr.66/2000, Gjykata vlerësoi se nuk ka bazë për t'iu referuar diskriminimit mbi bazë të përkatësisë sociale kur parashtruesit iu rrënuar objekti i ndërtuar në mënyrë të paligjshme, ndërsa argumentin se disa të tjerëve, në të njëjtën zonë, nuk u janë rrënuar objektet e paligjshme e vlerësoi si irrelevant edhe në domenin e veprimit të autoriteteve kompetente.

Për dallim nga rastet e këtu triviale, me vendimin U.nr.125/2015, Gjykata Kushtetuese vendosi ta refuzojë kërkesën për mbrojtjen e së drejtës për mos diskriminim mbi bazë të statusit të paraqitur nga një notere, të cilës i është refuzuar kërkesa për vazhdimin e punës si notere deri në moshën 64 vjeçare. Gjykata Kushtetuese, sikur ministri kompetent i Drejtësisë dhe gjykatat administrative, vlerësoi se Ligji për Marrëdhënie Pune nuk mund të zbatohet për noterët dhe se noteres i pushon funksioni kur do t'i përmbushë kushtet për pension pleqërie, përkatësisht, në moshën 62 vjeçare. Gjykata vlerësoi se diferenca në trajtimin është e justifikuar, bëhet fjalë për sektorë të ndryshëm të ushtrimit të veprimtarisë, përkatësisht të punës, dhe se ajo nuk është e diskriminuar në krahasim me noteret e tjera.

### **• mbi bazë të përkatësisë kombëtare/etnike, politike dhe fetare dhe mbi bazë të gjinisë**

Gjykata Kushtetuese, në tri raste, i refuzoi kërkesat e qytetarëve me përkatësi kombëtare rome, me të cilat kërkohet të përcaktojë diskriminim mbi bazë etnike.

Me vendimin U. nr.2/2019, datë 4.3.2020, Gjykata e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e të drejtës së mos diskriminimit të disa qytetarëve me kombësi rome, e cila u është shkelur me aktvendimet e Ministrisë së Brendshme për ndalimin e përdorimit të letërnjoftimeve për kalimin e kufirit, të cilët janë transferuar pasi që u deportuan nga Gjermania, por pa pasur kërkesë nga gjykata. Parashtruesit nuk arritën ta mbrojnë këtë të drejtë para gjykatave të rregullta, të cilat vlerësuan se jo vetëm romëve, por edhe personave të tjerë u janë lëshuar aktvendime të këtu triviale, dhe prandaj nuk ka diskriminim. Gjykata Kushtetuese, pas një Seance dëgjimore publike, vlerësoi se "element kyç në rastin konkret është fakti i deportimit, por jo përkatësia kombëtare përkatësisht etnike. Një ndalim i këtu triviale për kalimin e kufirit shtetëror u zbatua edhe për persona të tjerë të deportuar, të cilëve iu shqiptua ndalim për përdorimin e dokumentit të udhëtimit. Nga kjo rezulton qartë se edhe personave të tjerë që janë kthyer me detyrim, përkatësisht janë deportuar, iu hoqën dokumentet e udhëtimit, pavarësisht përkatësisë kombëtare, që do të thotë se edhe personat e tjerë që kishin statusin e të deportuarve, kishin trajtim të barabartë dhe të njëjtit u trajtuan në përputhje me dispozitat e Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit. Njëkohësisht, edhe për personat e tjerë të deportuar, autoriteti kompetent miraton Aktvendim për ndalimin e përdorimit të dokumentit të udhëtimit, në përputhje me nenin 37 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit, dhe gjatë miratimit të tij nuk lejohet kurrfarë selektiviteti mbi asnjë bazë. Kjo, me qëllim që shteti të ndërmarë masa kujdesi për të gjithë personat që kanë statusin e të deportuarve, përkatësisht statusin e të dëbuarve nga një shtet tjetër, me qëllim të mbrojtjes së sigurisë në tërësi. Veprime të këtu triviale janë ndërmarë edhe ndaj personave të tjerë të dëbuar, dhe jo vetëm ndaj aplikantëve, prandaj nuk mund të pranohet pretendimi i aplikantëve se në këtë rast ka sjellje diskriminuese."

Me vendimin U. nr.108/2019, Gjykata Kushtetuese nuk përcaktoi diskriminim mbi bazë të përkatësisë etnike në rastin e prishjes me detyrim të kampit në Kalanë e Shkupit dhe shpërnguljen e romëve që banonin aty. Më parë, gjykatat e kanë refuzuar padinë për diskriminim të tërthortë. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se parashtruesit e kërkesës nuk dëshmuar se kampi ishte prishur vetëm për shkak të qëndrimit të romëve në të dhe se nuk caktuan “komparator” të diskriminimit të tërthortë. Sipas mendimit të Gjykatës Kushtetuese, qëllimi i veprimeve të ndërmarra nga autoritetet kompetente ndaj komunitetit që u vendos në tokën ndërtimore private, të huaj të pa ndërtuar, nuk ka qenë që këta persona të shpërngulen me detyrim nga banesat e tyre, siç pretendojnë parashtruesit e kërkesës. Aktivitetet e ndërmarra kishin për qëllim largimin e personave të vendosur në mënyrë të paligjshme në tokë të huaj ndërtimore, në pronësi private, jo vetëm si mbrojtje të pronës së të tjerëve (Grupi SHPKNJP Amadeus), por kryesisht për shkak të ndotjes së natyrës dhe mjedisit dhe rrezikut të zjarrit për shkak të akumulimit të madh të mbetjeve të ndryshme, lehtësisht të djegshme. Një mjedis i shëndetshëm dhe i pastër është me interes jetësor për çdo qytetar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërkaq ky është një qëllim legjitim për veprimet e ndërmarra, kundrejt mbrojtjes së vendbanimeve të improvizuara të personave pjesëtarë të komunitetit rom. Pastaj, GJEDNJ-ja, me vendimin 46889/16 datë 24.6.2021, gjeti se aplikacioni për shkëljen e nenit 3 dhe 8 të Konventës, në këtë rast, ishte i papranueshëm, me ç'rast përsëriti se kishte një interes legjitim të shtetit për t'u ballafaquar me rreziqe, si në rastin konkret, për të mbrojtur shëndetin dhe të drejtat e të tjerëve.

Me vendimin U. nr.52/2020, Gjykata e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e të drejtës së mos diskriminimit, të parashtruar nga një qytetar me kombësi rome, të cilit i ishte shkëlur kjo e drejtë me përdorimin e forcës ndaj tij në ambientet e qendrës për çështje sociale, vetëm se është rom. Mbas Seancës dëgjimore publike, Gjykata konstatoi se parashtruesit e kërkesës kishin sjellje agresive ndaj të punësuarve, dhe pas kësaj vijoi ndërhyrja e personave zyrtarë, me ç'rast vlerësoi se, duke e pasur parasysh se procedura kontestuese nuk ishte ndërmarrë për shkak të përkatësisë kombëtare, në këtë rast nuk pati diskriminim.

Në një nga rastet, parashtruesi i është referuar diskriminimit mbi bazë të përkatësisë kombëtare, në një situatë ku marrëdhënia e tij e punës nuk ishte transformuar nga marrëdhënia me kohë të caktuar, në marrëdhënie në kohë të pacaktuar (U.nr.99/2019). Parashtruesi ishte i mendimit se kjo ishte pasojë e diskriminimit të tij për shkak se ishte vllëh, por Gjykata përcaktoi se arsyet e punëdhënësit ishin kryekëput të lidhura me nevojat e procesit të punës. Në një rast tjetër, parashtruesi ka pretenduar se është diskriminuar kur për një vend pune është përzgjedhur një kandidat tjetër, por Gjykata përcaktoi se kandidati i përzgjedhur i ka plotësuar kushtet e konkursit dhe nuk ka prova se parashtruesi është eliminuar mbi bazë kombëtare. Në një rast tjetër, punonjësit kanë pretenduar për diskriminim kombëtar dhe fetar, sepse nuk u ishte paguar kompensimi për transport dhe ushqim, por Gjykata përcaktoi se kompensime të tillë nuk u paguheshin as punonjësve të tjerë, maqedonas, turq, shqiptarë, të cilët gjithashtu kanë ngritur padi në gjykata (U.nr.42/2018). Disa punonjës të tjerë pretendonin se ishin të diskriminuar mbi bazë të përkatësisë kombëtare dhe politike (shqiptarë dhe anëtarë të BDI-së) kur vendet e tyre të punës pushuan së ekzistuari në NP Aeroporti Shkup. Gjykata vlerësoi se pushimi së ekzistuari të vendeve të punës kishte të bëjë me procesin e punës, dhe jo me përkatësinë kombëtare dhe politike të personave që punonin në ato vende pune (U.nr.227/2007). Si përfundim, Gjykata nuk gjeti diskriminim mbi bazë të përkatësisë politike dhe as në proceset e riorganizimit të ndërmarrjes publike, duke e përfshirë ri-sistemimin e vendeve të punës, pushimin së ekzistuari të vendeve të punës dhe shpalljen e tepricës teknologjike. Gjykata vlerësoi se nuk mund të dëshmohet se kaq shumë ndryshime janë bërë me qëllim të eliminimit të anëtarëve të një partie politike, të cilët as nuk deklaroheshin si të tillë, dhe as nuk mund ta dinte punëdhënësi se cilës parti politike i përkisnin ata, meqë kjo e dhëna nuk ishte kusht për punësim. (U.nr.67/2004).

Në një rast, Gjykata e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e të drejtës së mos diskriminimit mbi bazë të seksit, kur parashtruesi, një burrë, pretendonte se gruaja e tij, e cila ishte e dhunshme ndaj tij, ishte e privilegjuar në procedurën e mbrojtjes nga dhuna në familje dhe gjykatat vendosën në favor të saj vetëm për shkak se ajo ishte grua. Gjykata, nga përmbajtja e kërkesës, përcaktoi se parashtruesi i referohej vetëm ndalimit të diskriminimit, por në të vërtetë objekt i kërkesës është që kjo gjykatë t'i rishikojë vendimet e gjykatave në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e së drejtës materiale (U. nr.66/2021).

## Aktvendime për hedhjen poshtë të kërkesës

Gjykata Kushtetuese, natyrisht, e njeh kompetencën e saj dhe kushtet e paraqitjes së kërkesës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, kështu që aktvendimet për hedhjen poshtë të tyre, në një numër të madh rastesh, bazohen në mangësi evidente, siç është skadenca e afatit prej 2 muajsh për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje ose parashtrimin e kërkesave për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, për të cilat Gjykata nuk është kompetente, përkatësisht që nuk bëjnë pjesë në përfshirjen e nenit 110, alinesë 3 të Kushtetutës apo paraqitjen e kërkesave nga personat juridikë.

Duhet të nënvizohet se përveç lëshimeve evidente formale në kërkesat, të cilat i përmendëm më lart, si bazë për hedhjen poshtë të tyre, Gjykata e parasheh edhe rrethanën kur në to parashtruesit, “duke përdorur të drejtën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të nenit 110, alinesë 3 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, parashtruesi i kërkesës, në të vërtetë, kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë të vlerësojë nëse gjykata e shkallës së parë dhe të dytë, në lëndën e saj në fjalë, veprimi në mënyrë të drejtë/korrekte, përkatësisht se a i kanë aplikuar dispozitat adekuate të Ligjit për Procedurë Penale, ndërkaq në lidhje me këtë, pala ka bindje të kundërt. Kjo, në fund të fundit, do të thotë se Gjykata Kushtetuese, në rastin në fjalë, duhet të vendosë për çështje që nuk janë në kompetencë të saj, por janë në kompetencë të gjykatave të tjera ” (aktvendimi U.nr.146/2003). Në këtë kontekst, Gjykata vuri në dukje se “ajo nuk është në pozitën e instancës së një gjykate më të lartë të vendosë për çështjen në fjalë që është në kompetencë të gjykatave të tjera, madje as nuk është kompetente të vendosë për të drejtat dhe interesat e palëve të përcaktuara me akte të veçanta në lëndët në fjalë.” (U.nr.8/2004). Hedhjet poshtë të kështilla janë në numër të konsiderueshëm.

Megjithatë, disa aktvendime për hedhjen poshtë të kërkesave rezultojnë problematike në aspekte të caktuara, veçanërisht ato që janë miratuar sipas kërkesave që më vonë u parashtruan me sukses në GJEDNJ. Qysh në fillim të kësaj Analize, e apostrofuam aspektin problematik të aktvendimeve, me të cilat hidhen poshtë kërkesat kundër akteve përfundimtare për të cilat nuk është iniciuar procedurë gjyqësore, ose një procedurë e tillë është në rrjedhë e sipër, siç i emërton Gjykata kohëve të fundit, si kërkesa “të parakohshme”, gjë të cilën e konsiderojmë absolutisht të gabuar dhe në dëm të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

Përveç këtyre, duhet të theksohen edhe këto si vijon:

- Me **Aktvendimin U.nr. 342/195 datë 31.1.1996**, Gjykata e hodhi poshtë kërkesën e qytetarëve nga Komuna e Dibrës, me të cilën kërkohet mbrojtja e lirive dhe të drejtave në fushën e arsimit, nga diskriminimi mbi bazë të përkatësisë kombëtare, dhe pamundësimin e fëmijëve të parashtruesve për t'u arsimuar në gjuhën turke. Duke e shqyrtuar kërkesën, Gjykata përcaktoi se me kërkesën nuk kërkohet mbrojtja e lirive dhe të drejtave të shkelura me një akt të veçantë përfundimtar ose të formës së prerë, përkatësisht me veprimin e ndërmarrë, me ç'rast, në përputhje me nenin 113 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe nenin 51 të Rregullores së Gjykatës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë është kompetente të vendosë, por bëhet fjalë për akte të veçanta që nuk janë përfundimtare ose të formës së prerë dhe se nuk janë ndërmarrë veprime në kuptimin e nenit 51 të Rregullores së Gjykatës, kështu që kërkesa është jashtë kuadrit të kompetencave kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë.

Sipas pretendimeve në kërkesë, liritë dhe të drejtat e lartpërmendura janë shkelur me atë që Ministria nuk u është përgjigjur kërkesave të qytetarëve që fëmijët e tyre të arsimohen në gjuhën turke; duke mos lejuar që këta fëmijë të hyjnë në Shkollën “Nexhati Zekirija” në fshatin Koxhaxhik – Komuna e Dibrës, në të cilën mësimi zhvillohet në gjuhën turke; duke i refuzuar lutjet e prindërve që fëmijët e tyre të regjistrohen në shkollën në fjalë në paralelet në gjuhën turke; duke iniciuar procedura kundërvajtjeje kundër prindërve për mos dërgimin e fëmijëve të tyre në një shkollë në gjuhën maqedonase dhe duke miratuar aktvendime për shqiptimin e dënimeve monetare kundër prindërve, për mos dërgimin e fëmijëve në një shkollë në gjuhën maqedonase. Së këtejmi, është e vështirë të pranohet se në këtë rast nuk ka pasur akte dhe as veprime, kur është evidente se ka pasur edhe pengesa fizike për hyrjen e fëmijëve në shkollë dhe refuzimin e autoriteteve kompetente që t'u përgjigjen ose të marrin vendim në lidhje me kërkesat e prindërve që fëmijët

e tyre të arsimohen në gjuhën amtare. Mund të thuhet se hedhja poshtë e kërkesës, në këtë rast, është shembull i formalizmit të tepruar.

- Me **aktvendimin U.nr.182/2009 datë 9.9.2009**, Gjykata e hodhi poshtë kërkesën e parashtrueses për mbrojtjen e lirisë fetare, të shkelur me refuzimin e gjykatave, që ta regjistrojnë grupin fetar “Manastiri Stavropigjial”, të cilit ajo i përkiste.

Nga pretendimet e kërkesës dhe nga dispozitat e cituara të Kushtetutës dhe Rregullores, Gjykata vlerësoi se, konkretisht në këtë rast, parashtruesja vetëm formalisht dhe deklarativisht i referohet mbrojtjes së lirive dhe të drejtave, pa dhënë argumente, as prova dhe fakte se me çka ka të bëjë diskriminimi dhe shkelja e së drejtës së fesë, përkatësisht besimit fetar. Nga ana tjetër, parashtruesja kërkon nga Gjykata Kushtetuese ta rishikojë zbatimin e ligjit nga gjykatat e rregullta, në aktet konkrete, me të cilat u vendos në lidhje me kërkesën për regjistrimin e grupit fetar të cilit i përkiste parashtruesja në Regjistrin Unik Gjyqësor, por sipas kompetencës së Gjykatës, të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente ta vlerësojë dhe rishikojë zbatimin e ligjit nga gjykatat në procedurat e rregullta gjyqësore.

Më pas, GJEDNJ-ja, me aktgjykimin 52849/09, datë 29.11.2018, përcaktoi se refuzimi i regjistrimit, të cilin Gjykata Kushtetuese nuk e ka perceptuar në kontekstin e sendërtimit të lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit, paraqet shkelje të nenit 9 dhe 11 të Konventës dhe nuk mund të pranohet si e domosdoshme, në një shoqëri demokratike.

Në të njëjtën mënyrë si në lëndën paraprake, Gjykata veprroi në lidhje me aktvendimin U. nr.118/2010 datë 15.12.2010, me të cilin e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit nga neni 110, alineja 3 e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, që kanë të bëjnë me lirinë e besimit dhe ndalimit të diskriminimit mbi bazë të përkatësisë fetare, të shkelur me mos regjistrimin e grupit fetar “Kryepeshkopata Greko-Ortodokse e Ohrit e Patriarkanës së Pejës”.

Gjykata vlerësoi se në kërkesë, parashtruesi, anëtar i sinodit të grupit fetar, nuk kufizohet vetëm në kërkesën për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, si një e drejtë personale e individit, por në emër të grupit paraqet pretendime lidhur me veprimet dhe aktet e procedurave për regjistrimin e grupit fetar të cilit i përkiste. Në të vërtetë, me kërkesën, vetëm parimisht inicohet Gjykata Kushtetuese, përmes rishikimit të veprimeve dhe akteve të organeve administrative kompetente për veprim dhe vendimmarrje sipas kërkesës për paraqitjen dhe regjistrimin e grupit fetar, si në rastin e parashtruar konkret, të përcaktojë se autoritetet kompetente kanë vepruar gabimisht dhe në mënyrë të paligjshme, si dhe t’ju urdhërojë ta përmbushin kërkesën, por Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë për këtë, as nuk e ka rolin e instancës së gjykatës të shkallës më të lartë që do ta rishikojë ligjshmërinë e procedurave dhe akteve të autoriteteve kompetente. Kjo, aq më shumë që regjistrimi, përkatësisht mos regjistrimi i komunitetit fetar, gjegjësisht grupit fetar, nuk i determinon përcaktimet fetare dhe ndjenjat e brendshme fetare të individit, pasi shprehja e ndjenjave është një akt individual, ndërsa procedura e regjistrimit të grupit fetar në fjalë nuk ndikon në besimin personal fetar, si dhe në kryerjen e punëve dhe riteve fetare, për shkeljen eventuale të të cilave Gjykatës nuk i janë paraqitur prova adekuate. Shihet se Gjykata e ka neglizhuar tërësisht aspektin kolektiv të realizimit të lirisë së besimit fetar “në bashkësi me të tjerët” me ç’rast regjistrimi i grupit fetar është i një rëndësie të veçantë, ndërkaq Gjykata i është shmangur vendimmarrjes.

Në mënyrë të njëjtë si në rastin paraprak veprroi GJEDNJ, e cila me aktgjykimin 3532/07 datë 16.11.2017 përcaktoi shkelje të lirisë së besimit sipas nenit 9 dhe të drejtës së shoqërimit të këtij grupi fetar sipas nenit 11 të Konventës.

Me aktvendimin U.nr.108/2013 datë 18.5.2015, Gjykata e hodhi poshtë kërkesën e Xhenifer Xheladin nga Shkupi, me kombësi rome, për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të nenit 110, alinesë 3 të Kushtetutës, të shkelura me ndalimin diskriminues për kalimin e kufirit shtetëror, duke u ndarë nga grupi i pasagjerëve për shkak të ngjyrës së lëkurës, duke kërkuar të tregojë një letër garancie, për shkak të faktit se ajo më parë ishte deportuar nga një vend evropian.

Gjykata vuri në dukje se veprimi në fjalë i nëpunësit të autorizuar, i cili ka qenë pjesëtar i shërbimit kompetent të policisë kufitare pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, në rastin konkret, përbën një veprim të rregulluar me ligj. Nga ana tjetër mungojnë fakte dhe prova relevante për ekzistencën e vep-

rimeve me parashenjën e elementeve të diskriminimit, të cilat mund të merren parasysh gjatë analizës, kurse më pas edhe gjatë vendimmarrjes sipas kërkesës për mbrojtje nga diskriminimi, përkatësisht nga provat se edhe në gjendjen e përmbushjes së të gjitha supozimeve ligjore për kalimin e kufirit, përkatësisht në mungesë edhe të të gjitha pengesave të mundshme ligjore, parashtruesja dhe familja e saj u trajtuan ndryshe dhe në mënyrë të pafavorshme në krahasim me qytetarët e tjerë në pikën e kalimit kufitar. Njëherësh, Gjykata përcaktoi se mungojnë prova se veprimi i zyrtarit të autorizuar ishte kryekëput vetëm për shkak të arsyeve të deklaruara të përkatësisë në kërkesën, dhe jo si masë juridike, në përputhje me ligjin, dhe për këtë arsye, në rastin konkret, nuk u përmbushën supozimet procedurale nga neni 52 i Rregullores së Gjykatës Kushtetuese për vendimmarrjen meritorë të kësaj gjykate sipas kërkesës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave mbi bazat e pretenduara.

Arsyetimi i mësipërm tregon se Gjykata e ka vlerësuar vlerën e pretendimeve të parashtrueses, ka përcaktuar se nuk ka prova në kërkesën për pretendimet e saj dhe ka nxjerrë konkluzione se trajtimi i saj nuk ishte domosdoshmërisht për shkak të përkatësisë së saj kombëtare, megjithatë nuk ka hapur procedurë që t'i përcaktojë ato rrethana në mënyrë që ta përmbushë funksionin e saj, të vlerësojë në mënyrë të mirëfilltë se a ka apo nuk ka elemente diskriminimi. Kur do ta pranonte kompetencën për të vendosur në mënyrë meritorë, do të kishte mundësi të zhvillojë Seancë dëgjimore publike, t'i marrë në pyetje personat dhe zyrtarët e involvuar, t'ua ofrojë mundësinë për të paraqitur prova, përfshirë edhe dëshmitarët. Në këtë mënyrë me sa duket Gjykata bëhet e shurdhër ndaj detyrës së saj, të cilën të gjithë janë në pritje që ta përmbushë.

Më vonë, GJEDNJ, me vendimin 43440/15 datë 3.9.2019, e konstatoi deklaratën e njëanshme të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut se në këtë rast e njohu shkeljen në lidhje me nenin 2 të Protokollit nr. 4 (liria për t'u larguar nga territori i shtetit) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 (ndalimi i diskriminimit). Vetëm Gjykata Kushtetuese nuk arriti ta mbrojë këtë qytetare nga sjellja diskriminuese e zyrtarëve.

Gjykata të njëjtin lëshim e bëri edhe me aktvendimin U. nr.99/2013 datë 5.2.2014, me të cilin e hodhi poshtë kërkesën për mbrojtje nga diskriminimi të një pjesëtari tjetër të bashkësisë rome, në rrethana dukshëm të ngjashme.

Përfundimisht, me aktvendimin U.nr. 132/2018, datë 18.9.2019, Gjykata e hodhi poshtë kërkesën e Seriha Elmazovës dhe të tjerëve nga Manastiri, për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave nga neni 110, alineja 3 e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, që kanë të bëjnë me ndalimin e diskriminimit të qytetarëve mbi bazë të racës dhe përkatësisë kombëtare, në lidhje me realizimin e së drejtës për arsimimin e nxënësve – romë, në Shkollën Komunale Fillore “Gjorgji Sugarev”- Manastir dhe Shkollën Komunale Fillore “Todor Angelevski” – Manastir, në të cilat kontestohet praktika e segregimit të fëmijëve - romë.

Gjykata, në një rast kaq serioz dhe senzitiv, e mori përgjegjësinë të deklarojë se “në një situatë kur nuk janë paraqitur prova në Gjykatë nga e cila mund të vërtetohet me siguri se parashtruesit në fjalë të kërkesës i janë nënshtruar trajtimeve të ndryshme nga shkollat dhe se u është mohuar e drejta e arsimit, duke e refuzuar regjistrimin në shkollë, vlerësoi se në këtë rast nuk janë përmbushur supozimet procesuale të nenit 52 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese për shënimin në vendimin meritor sipas kërkesës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, përkatësisht se e njëjta duhet të hidhet poshtë”.

Fatmirësisht, parashtruesit e kërkesës pastaj iu drejtuan GJEDNJ-së, e cila, me aktgjykimin 11811/20 dhe 13550/20 datë 13.12.2022, përcaktoi shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) dhe nenit 2 të Protokollit Nr.1 (e drejta për arsim) dhe e detyroi shtetin e paditur, RMV-në, të marrë masa individuale për t'i dhënë fund segregimit të nxënësve romë në të dy shkollat shtetërore. Edhe në këtë rast, Gjykata Kushtetuese nuk e ka kuptuar misionin e saj.

### 3. MONITORIMI I SEANCAVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE NË PERIU DHËN K O H O R E P R I L L - T E T O R 2023

Monitorimi i seancave të Gjykatës Kushtetuese u implementua në bazë të zbatimit të parimeve të profesionalizmit, objektivitetit, paanshmërisë dhe neutralitetit. Qëllimi i monitorimit konsiston në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe kualitative për punën e Gjykatës Kushtetuese, me theks të veçantë mbi kërkesat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, por edhe mbi vendimmarrjen dhe veprimin gjithëpërfshirës të Gjykatës Kushtetuese, duke marrë në konsideratë kompetencat kushtetuese.

Të dhënat që rezultojnë nga monitorimi i punës së Gjykatës Kushtetuese përpunohen në bazë të një metodologjie të paracaktuar përmes së cilës mund të analizohen situata të caktuara, siç është mënyra e përpilimit të referateve, transparenca në vendimmarrje, bashkëpunimi i institucioneve kompetente, duke lënë hapësirë për hapjen e dyshimeve të caktuara në drejtim të promovimit të këtij mekanizmi, si për shembull, a mundet vetë Gjykata Kushtetuese të iniciojë procedurë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, nëse konstaton se ka bazë.

Lidhur me transparencën dhe llogaridhënien, në periudhën e kaluar mund të konstatohet se Gjykata Kushtetuese e publikon rregullisht rendin e ditës, me përjashtim të seancës XXII dhe XXIX, për të cilat rendi i ditës u publikuar pas fillimit të seancave. Rregullisht publikohen njoftimet pas zhvillimit të seancave, si dhe arsyetimi i detajuar i tyre në lidhje me vendimet ndaj referateve, vendimeve dhe aktvendimeve pasi që lëndët bëhen përfundimtare.

#### **Veprimet e Gjykatës Kushtetuese ndaj kërkesave të paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave – gjetjet nga monitorimi**

Në periudhën midis muajve prill-tetor 2023, Gjykata Kushtetuese ka vendosur ndaj 13 kërkesave për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, si vijon:

- 1 kërkesë me propozimin e gjyqtarit-raportues nuk e ka marrë shumicën e nevojshme dhe është shtyrë për një nga seancat e ardhshme;
- 2 kërkesa janë pranuar dhe mbi të njëjtat është vepruar;
- 6 kërkesa u hodhën poshtë dhe
- 4 kërkesa u refuzuan si të pabaza.

Ajo që mund të vërehet gjatë monitorimit të punës së Gjykatës Kushtetuese konsiston në atë se për shumicën e kërkesave Gjykata nuk ka vendosur madje deri 3-4 vjet pas paraqitjes së tyre, gjë që është në kundërshtim me Rregulloren e cila përcakton se për kërkesat është parashikuar urgjencë gjatë vendimmarrjes,<sup>7</sup> përkatësisht në afat prej 30 ditëve pas përfundimit të procedurës paraprake, krahasuar me nismat për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, me ç'rast Rregullorja lë mundësi për vendimin e tyre deri në 3 muaj pas përfundimit të procedurës paraprake.

7 Shih nenin 23 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese të RMV-së.

Në vazhdim janë veçuar disa nga kërkesat më të rëndësishme për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, për të cilat ka vendosura Gjykata Kushtetuese në këtë periudhë raportuese:

**Kërkesë për liritë dhe të drejtat - Referati U.nr. 146/2021, vendosur në Seancën e 27-të të mbajtur më datë 12.7.2023**

**Parashtrues:** Vllatko Stojanovski , përmes avokatit Filip Medarski nga Shkupi

Parashtruesi i kërkesës konsideron se me aktgjykimet e dy gjykatave, Gjykatës Themelore Civile Shkup dhe Gjykatës së Apelit Shkup, është shkelur liria e shprehjes e garantuar me Kushtetutë dhe nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Sipas tij, shteti, nëpërmjet institucioneve përkatëse shtetërore, nuk e ka garantuar sigurinë e tij në datë 27.4.2017 gjatë kryerjes së detyrës së punës në Kuvend, ndërsa të dy gjykatat, me aktgjykimet e tyre, nuk i kanë marrë parasysh kërkesë-paditë për shkeljen e lirisë së shprehjes dhe ngjarjeve që i kanë ndodhur, përkatësisht sulmet direkt ndaj tij në Kuvend, sepse si gazetar ka raportuar për çështje me interes publik (konstituimi i shumicës së re parlamentare).

**Vendim:**

Përcaktohet shkelja e lirisë së shprehjes publike të mendimit të Vllatko Stojanovskit nga Shkupi, i përfaqësuar nga avokati Filip Medarski nga Shkupi, e kryer me Aktgjykimin MALVP- 705/20 datë 14.4.2021, të Gjykatës Themelore Civile Shkup dhe aktgjykimin GZh-2666/21 datë 30.9.2021 të Gjykatës së Apelit Shkup.

Në Seancën e sotme, Gjykata Kushtetuese miratoi vendim me të cilin u përcaktua se është bërë shkelje e lirisë së shprehjes publike të mendimit të Vllatko Stojanovskit të kryer me dy aktgjykime, njëri nga Gjykata Civile Shkup në vitin 2021 dhe tjetri nga Gjykata e Apelit Shkup në vitin 2021.

Sipas Gjykatës, në të dy aktgjykimet nuk është përcaktuar shkelje të lirisë së shprehjes së Vllatko Stojanovskit, si gazetar i Fokusit, gjatë ngjarjeve të 27 prillit 2017 në Kuvend.

Pika e referimit të këtij këndvështrimi të Gjykatës konsiston me atë se liria e medias, si pjesë përbërëse e lirisë së shprehjes, e përfshin lirinë e informimit publik dhe marrjen dhe transmetimin e lirë të informacioneve për çështje me interes publik.

E gjithë kjo është parakusht për ekzistencën e një shoqërie demokratike, pasi komunikimi i lirë i informacioneve dhe ideve për çështje politike dhe çështje të tjera shoqërore me interes publik janë të rëndësishme thelbësore.

Kjo nënkupton lirinë e medias për të marrë informacione në bazë të të cilave do të mund ta ushtrojnë rolin e tyre, të komentojnë dhe raportojnë për të gjitha çështjet e rëndësishme me interes publik.

Këto rrethana janë të rëndësishme dhe relevante, por nuk janë marrë parasysh nga gjykatat kompetente që kanë vendosur ndaj kërkesës së parashtruesit.

Vendimi është deklarativ me të cilin aplikuesi do të mund t'i sendërtojë të drejtat e tij para gjykatave kompetente.



**Parashtrues:** Fatmir Memedov

Parashtruesi i kërkesës u ankua në Gjykatën Kushtetuese se është diskriminuar mbi bazë të përkatësisë kombëtare, gjë që nënkupton edhe përkatësinë etnike. Parashtruesi i kërkesës i konteston të dy aktgjykimet të Gjykatës Themelore Shkup 2 dhe të Gjykatës së Apelit Shkup për të cilat pretendon se Prokuroria Themelore Publike Shkup ia ka shkelur dinjitetin me sjelljen diskriminuese për shkak të përkatësisë së tij etnike, sepse nuk kanë zbatuar procedurë hetimore, dhe nuk kanë ndërmarrë veprime mbi ankesën e paraqitur penale në periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2016, me një kërkesë pasurore juridike prej 130 mijë denarë në emër të kompensimit të dëmit jo material për dhimbje shpirtërore dhe shkelje të të drejtave personale, me kamatë. Parashtruesi pretendon se është sulmuar fizikisht nga oficerët e policisë sepse është rom, pa asnjë shpjegim.

**Vendim:**

Gjykata Kushtetuese përcaktoi shkelje të të drejtave dhe lirive të parashtruesit Fatmir Memedov, i cili me kërkesë është ankuar se është diskriminuar në bazë të përkatësisë kombëtare, që nënkupton edhe përkatësinë etnike. Parashtruesi pretendon se është sulmuar fizikisht nga oficerët e policisë sepse është rom, pa asnjë shpjegim. Kontestohen dy aktgjykimet të Gjykatës Themelore Shkup 2 dhe të Gjykatës së Apelit Shkup për të cilat pretendon se Prokuroria Themelore Publike Shkup ia ka shkelur dinjitetin me sjelljen diskriminuese për shkak të përkatësisë së tij etnike, sepse nuk kanë zbatuar procedurë hetimore, dhe nuk kanë ndërmarrë veprime mbi ankesën e paraqitur penale në periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2016, me një kërkesë pasurore juridike prej 130 mijë denarë në emër të kompensimit të dëmit jo material për dhimbje shpirtërore dhe shkelje të të drejtave personale, me kamatë.

Sa i përket pikës së dytë të propozimit, e cila parashikon shfuqizimin e aktgjyqimeve të kontestuara, Gjykata Kushtetuese nuk ka marrë vendim, sepse propozimi nuk ka marrë shumicën e nevojshme, prandaj kjo lëndë akoma nuk ka përfunduar.

# KONKLUZIONE

---

- Nga analiza gjithëpërfshirëse e kërkesave të paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në tri dekadat e fundit, mund të konkludohet se bëhet fjalë për një numër të vogël kërkesash të paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave në Gjykatën Kushtetuese. Arsyeja për një gjë të këtillë mund t'i referohet përfshirjes së kufizuar të hartuesve të Kushtetutës në vitin 1991, kur përcaktuan se për cilat liri dhe të drejta në Kushtetutë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtje, si dhe instrumentet e tjera ekzistuese, siç janë procedurat para gjyqësorit të rregullt, me të cilat mund të mbrohen liritë dhe të drejtat. Arsyet e tjera mund të locohen edhe në periudhën e gjatë kohore të veprimit të Gjykatës Kushtetuese, si dhe në mungesën e informacionit të qytetarëve për mundësinë e paraqitjes së kërkesave për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, me ç'rast, në atë segment, nevojitet edukim më i madh.
- Nevojitet që Gjykata Kushtetuese të veprojë në mënyrë më thelbësore ndaj kërkesave për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, dhe jo vetëm t'i hedhë poshtë në mënyrë procedurale, me ç'rast Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut do t'i implementonte drejtpërdrejt. Trajtimi jo thelbësor i kërkesave për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave është në kundërshtim me Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese dhe praktikën e GJEDNJ-së.
- Nga analiza e kërkesave të paraqitura, mund të përcaktohet një problematikë e caktuar, e cila është konstatuar edhe në lëndë të caktuara të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut sa u përket aktvendimeve me të cilat hidhen poshtë kërkesat kundër akteve përfundimtare për të cilat nuk është iniciuar procedurë gjyqësore ose një procedurë e tillë është në rrjedhë e sipër, megjithatë Gjykata Kushtetuese këto kërkesa i cilëson si "të parakohshme". Kërkesa për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave nuk është subsidiare, përkatësisht nuk është e nevojshme të absolvohen të gjitha mjetet juridike kundër aktit me të cilin është kryer shkelja e lirive dhe të drejtave kushtetuese. Një veprim i ndryshëm i Gjykatës do të ishte në kundërshtim me Rregulloren.
- Gjykata Kushtetuese jo gjithmonë ndjek praktikën e saj (konsistente) gjyqësore, ndërsa kur e bën këtë, nuk ofron argumente mjaftueshëm relevante për vendimin e atillë, edhe pse duhet ta ketë parasysh se praktika konsistente gjyqësore është pjesë e standardit të trajtimit/veprimit të ndershëm (neni 6 i KEDNJ-së). Është diskutabile çështja nëse Gjykata Kushtetuese, në këtë kuptim, mund t'i mbrojë liritë dhe të drejtat e caktuara për mbrojtjen e të cilave është jo kompetente ose kur një mbrojtje e tillë nuk është kërkuar nga Gjykata.
- Nga monitorimi i punës së Gjykatës Kushtetuese, mund të konstatohet se Gjykata nuk vendos në kohën e duhur për të gjitha kërkesat, përkatësisht nuk e respekton afatin e parashikuar në Rregullore.
- Nga monitorimi i punës së Gjykatës Kushtetuese, lidhur me kërkesat e paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, mund të konkludohet se nuk ka pasur prezencë të Avokatit të Popullit.
- Për të gjitha këto çështje nevojitet një diskutim profesional i cili duhet të jetë substancial dhe konstruktiv.

# REKOMANDIME

---

- Në punën e saj, Gjykata Kushtetuese duhet të vazhdojë t'i mbrojtë liritë dhe të drejtat e njeriut në kohën e duhur, në mënyrë cilësore, efektive, efikase dhe transparente, përmes prezantimit të argumenteve mjaftueshëm relevante për vendimin e saj, gjë që do ta rriste besimin në punën e kësaj gjykate.
- Është e nevojshme të analizohen arsyet për numrin e vogël të kërkesave të paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të punohet në të kuptuarit adekuat të domethënies së vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Për të rritur numrin e kërkesave të paraqitura për mbrojtje, duke e marrë parasysh se ato jo rrallëherë shkelen, është e nevojshme të veprohet përmes ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, kurse njëherësh edhe përmes edukimit të duhur me mundësinë e ofruar aktuale me aktet ekzistuese normative për mbrojtjen në fjalë.
- Nevojitet që Gjykata Kushtetuese të jetë më konsistente në vendimmarrjen e saj, përkatësisht ta aplikojë praktikën e saj tanimë të krijuar, ndërkaq nëse të njëjtën e ndryshon, të ofrojë argumente relevante për ndryshimin e tillë.
- Është e nevojshme të zhvillohen më shpesh Seanca dëgjimore publike në Gjykatën Kushtetuese, veçanërisht për përcaktimin e fakteve për një vendimmarrje cilësore dhe efektive ndaj kërkesës së paraqitur.
- Duke i marrë parasysh dispozitat e Rregullores së Gjykatës Kushtetuese dhe kompetencën e Avokatit të Popullit në fushën e mbrojtjes së lirive, duhet të bëhen përpjekje që ai të ftohet në seancat në të cilat vendoset mbi kërkesat e paraqitura për liritë dhe të drejtat.
- Veprimi me vetiniciativë i Gjykatës Kushtetuese nuk ka të bëjë me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, që do të thotë se ajo nuk mund ta zgjerojë me vetiniciativë kompetencën e saj, dhe as të vendosë për diçka që nuk është kërkuar prej saj. Kompetenca e saj është përcaktuar në mënyrë të qartë në dokumentet ekzistuese (në Kushtetutë dhe Rregullore). Në drejtim të përcaktimit të fakteve, të nevojshme për vendimmarrje cilësore, Seancat dëgjimore publike kanë rëndësi të veçantë. Ato, përveç që ofrojnë qasje edukative gjatë prezantimit të bazave dhe shkaqeve për vendimet e marra, e realizojnë edhe rolin arsimor, si në drejtim të paraqitjes së kërkesave për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, ashtu edhe në drejtim të vendosjes për të njëjtat.
- Nevojitet të organizohen trajnime të ndryshme, si për ushtrimin e kompetencës përkatësisht juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, ashtu edhe për aplikimin e praktikës së GJEDNJ-së për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, veçanërisht për shkak se interpretimi i KEDNJ-së është ekskluzivisht në kompetencë të GJEDNJ-së dhe vetëm një interpretim i tillë mund të zbatohet në punën e Gjykatës Kushtetuese. Duke e ndjekur praktikën e GJEDNJ-së, vendimet e Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë efikase dhe efektive dhe jo deklarative, që po ashtu rezulton nga praktika e GJEDNJ-së.
- Është i nevojshëm edhe monitorimi dhe aplikimi adekuat i praktikës së GJEDNJ-së, jo vetëm në aspektin e realizimit efektiv të mbrojtjes, por edhe në aspektin e reduktimit të numrit të lëndëve tona para GJEDNJ-së, ku është përcaktuar një numër i madh shkeljesh në proporcion me numrin e popullatës në vendin tonë, ashtu edhe sa i përket reduktimit të mjeteve monetare, të cilat, në situata të caktuara, shteti duhet t'ua paguajë kërkuarve të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave, dhe në fund lidhur me sendërtimin e imazhit pozitiv të shtetit në fushën e sundimit të ligjit para publikut kombëtar dhe ndërkombëtar. Besimi në ushtrimin e kompetencës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut është i një rëndësie jashtëzakonisht të madhe, jo vetëm në aspektin e efekteve të lartpërmendura, por edhe në besimin e popullatës në efikasitetin e realizimit të kërkesës së arsyeshme.
- Zgjerimi i kompetencës së punës së Gjykatës Kushtetuese dhe parashikimi i instrumenteve të reja për mbrojtje, nëse kjo nuk ofron rezultate të pritshme, nuk do të duhej të paraqesë një aktivitet vetëm sa për të kënaqur kërkesën për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara, nëse e njëjta nuk gjeneron rezultate pozitive dhe efektive. Nevojitet një seriozitet i jashtëzakonshëm në ndërmarrjen e aktiviteteve të tilla,

duke i analizuar ato nga të gjitha anët. Gjithsesi se gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve të tilla, duhet të merret parasysh edhe përgjegjësia për sjelljen jo përkatëse.

- Duke i perceptuar problemet specifike në sistemin juridik, nga aspekti i paqartësisë ose mangësive, Gjykata Kushtetuese duhet të bëjë përpjekje për zbatimin e drejtpërdrejtë të Kushtetutës, duke dhënë një justifikim më të gjerë juridiko-teorik në vendimet e marra. Sjellja e këtillë natyrisht se do t'u mundësojë gjykatave të rregullta që kompetencën e tyre ta ushtrojnë në mënyrë përkatëse.
- Veprimi cilësor, natyrisht se kërkon një veprim në kohën e duhur, dhe i njëjti duhet të respektohet, veçanërisht kur afati i veprimit është caktuar me Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese dhe nëse merren parasysh problemet organizative në vetë Gjykatën Kushtetuese.
- Ekipimi kadrovik, sa i përket numrit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, ashtu edhe sa i përket shërbimit profesional i cili ka nevojë për rritjen e të njëjtit, si dhe sa u përket financave të nevojshme për funksionimin normal të Gjykatës, janë elementë që nuk duhet të neglizhohen. Pikërisht e kundërta – në çdo aspekt duhet t'u jepet përparësi.
- Duhet në mënyrë gjithëpërfshirëse të diskutohet çështja e nevojës së ndryshimeve eventuale ose amendimit të dispozitave të Rregullores, si dhe sa i përket transparencës së diskutimeve dhe votimit të vendimeve për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, duke i marrë parasysh problemet e specifikuar (diferencën e diskutimeve dhe votimeve) të cilat u detektuan gjatë monitorimit të punës së Gjykatës Kushtetuese. Për këtë qëllim, mund të hartohet një analizë dhe një pasqyrë komparative e gjendjes, lidhur me çështjen e praktikës së gjykatave kushtetuese të rajonit.



